ARBEN BRAÇE

NJË JETË NË TRI BOTË

ROMAN

BOTIMET TOENA

ARBEN BRAÇE

NJË JETË NË TRI BOTË

roman

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2018

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Korrektore letrare: Arlinda Rrushi
Përkujdesja grafike: Elida Stafa
Kopertina: Joni Kraja

ISBN 978-9928-235-85-5

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë
Tel.: + 355 4 22 40 116
E-mail: redaksia@toena.com.al
botimet.toena@gmail.com
www.toena.com.al

Librin ua kushtoj të gjithë atyre që kanë vuajtur pasojat
e një sistemi politik të papërshtatshëm
dhe të një drejtësie të korruptuar.

Kapitulli i parë

Vizita e Romirit në spitalin psikiatrik të Tiranës ishte thjesht një rutinë për profesor Afrim Dragotin, një psikiatër i njohur, për të cilin thoshin se edhe vetë kishte filluar të shfaqte simptomat e pacientëve të tij. Mjeshtri e njohu njëherazi pacientin e vjetër. Ai i zgjati dorën në mënyrë kalorësiake dhe e orientoi të ulej në karrigen përbri. Profesori ishte një burrë që i kishte kaluar të gjashtëdhjetat, thatim, me shtat mesatar, me flokë pak të rënë, sikurse i ka hije vërtet një profesori. Ishte veshur me rroba të lodhura dhe të pakombinuara, karakteristikë kjo e shumë prej intelektualëve shqiptarë, të cilët janë kokëfortë për sa i përket pranimit të faktit se edhe vetë rrobat kanë konsum moral. Vitet e fundit, një gjeneratë e re njerëzish kishin filluar të visheshin shik, përfaqësues

të biznesit të madh jorentabël, politikanë të korruptuar, si dhe trafikantë droge, që për momentin ishin si bari i keq që rritet shumë më shpejt se bima. Avokat Avenirit, që shoqëronte Romirin, pacientin e vështirë, ai i zgjati dorën me respekt, por i la menjëherë të kuptonte që të mos shpresonte shumë nga kjo vizitë.

Biseda, që në fillim qe e lirë dhe e qetë. "Vetëm të sëmurët mendorë mund të braktisin me lehtësi vargonjtë e çfarëdolloj etike, moderne apo konservatore", mendoi Aveniri. Dukeshin shumë bukur. Hynë lirshëm në bisedë. Ndoshta njerëzit e së ardhmes do të jenë kështu. Të lirë dhe pa kurrfarë droje, për t'i thënë gjërat sikurse janë, pa u trembur për pasojat që lënë fjalët. Në fund të fundit, a nuk ishte vetë etika ajo që prej shekujsh i kishte shkaktuar njeriut gjithë ato neuroza? A nuk ishte vetë Frojdi që u orvat jo pak të çlironte botën nga pasojat e neurozave që shkaktojnë etikat e kohës? A nuk vinin neurozat si shkak i ndrydhjes së instinkteve, kryesisht atij seksual? Madje edhe vetë ideologët klasikë të komunizmit kishin thënë se, pas kalimit nga socializmi në komunizëm, do të ndryshonin tërësisht edhe marrëdhëniet etike midis njerëzve. Edhe marrëdhëniet seksuale do të ishin të lira, thjesht çështje afeksioni.

Këto po mendonte Aveniri teksa po vështronte Romirin, klientin e tij, i cili, edhe kur ulej në karrige, krijonte një pamje estetike. Nga mënyra sesi po e vështronte psikiatrin, dukej sikur ky i fundit ishte pacienti, për të mos thënë që ishte gjithmonë i kombinuar, refleks ky i edukatës, por

edhe i profesionit të piktorit, me të cilin ai ishte përpjekur të mposhte gjithë boshllëkun e jetës. Megjithëse biseda dukej si një dialog surrealist midis dy të çmendurve, ajo mori një drejtim interesant, pasi profesor Afrimi e pyeti me takt Romirin për origjinën. Pyetjes ai iu përgjigj menjëherë, duke i thënë se ishte i biri i avokatit të mirënjohur, Petraq Harizi. Ai, pasi kishte përfunduar studimet në Vjenë, kishte ardhur në qytetin e Durrësit me bekimin e Naltmadhnisë. Shqipërisë në atë kohë i duheshin intelektualë dhe njerëz të shkolluar për të ndërmarrë civilizimin, në emër të shkëputjes nga humnera e injorancës që kishte lënë pas Perandoria Osmane. Ai ishte nisur për studime, sepse në atë kohë, Naltmadhnia jepte një numër të konsiderueshëm bursash për në universitetet e Europës dhe të Amerikës. Romiri renditi, pa ndonjë mburrje e vëmendje të veçantë, se patrioti i mirënjohur, profesori i historisë, Teodor Harizi, ishte gjyshi i tij. Ai kishte studiuar në Francë dhe kishte dhënë një kontribut të vyer në pavarësinë e Shqipërisë, por edhe në shkrimin e historisë.

Romiri nisi të fliste shtruar për origjinën, pa u bërë merak fare për kohën e psikiatrit. Prej kohësh nuk fliste me miq. Ndiente nevojë të shprehej. Me një buzëqeshje të lehtë në fytyrë, nisi të rrëfente gjithë sagën e familjes. Si një romancier i sprovuar filloi të përshkruante se dita e nisjes së të atit për studime në Vjenë ishte një ditë e zakonshme vjeshte e shtatorit të vitit 1927. Në një ceremoni të organizuar nga Ministria e Arsimit me këtë rast, aty ndodhej edhe vetë Presidenti, për të cilin në Perëndim

ishte krijuar përshtypja që ishte i vetmi person që mund t'i besoje. Ai kishte energjinë e duhur për të bërë reforma të përshtatshme, për të transformuar vendin e shqiponjave, që me dashakeqësi dhe me injorancë politikanët dhe historianët fqinjë e quanin vend aborigjenësh. Studentët që do të niseshin atë vit, u betuan se do të angazhoheshin me të gjitha fuqitë për të pasur rezultate në studime. Presidenti qëndronte në krye të sallës i shoqëruar nga një tabor me roja. Ishte i veshur me një kostum të stilit perëndimor, ngjyrë gri, që nuk i shkonte aspak me fytyrën e vrazhdë dhe epike të malësorit.

Shumë më bukur do të dukej i veshur me kostum ushtarak ose popullor, kishte menduar me vete atë ditë Petraqi, sesa në stilin klasik, me të cilin dukej anakronik. Për më tepër që gjithmonë kishte menduar se, midis etimologjisë së mbiemrit të presidentit, kishte kundërshti roli. Zogun tokësor, kur e prek, të jep ndjesinë e afshit dhe të përhumbjes... ndërsa zogun fluturak, kur e prek, në pushin e vet, të bën të ndihesh i lehtë, sikur fluturon bashkë me të... Sa më shumë e vështronte, aq më shumë i bënte përshtypje teksa vinte re fytyrën burrërore dhe trupin prej kalorësi. Mund të ketë prejardhje nga zogu, por pa dyshim nga një zog gjigand prehistorik, nga i cili e ka prejardhjen shqiponja, finalizoi ai mendimin.

I përhumbur në këto mendime, nuk kishte vënë re që ceremonia përfundoi shpejt. Në fund, vetë Presidenti i kishte përshëndetur me një gegërishte të papërpunuar, e përshtatshme më shumë me gjuhën e të shkuarit në luftë,

sesa në një betejë shkence. Kishte pritur një gegërishte fishtjane, duke qenë se vinte nga juglindja! Një mjerim i vërtetë! Gjithsesi, ky ishte njeriu i duhur që kishte mundur ta shkëputse Shqipërinë nga dhëmbët e hienave europiane dhe fqinjëve të panginjur me gjak shqiptari. Në sy mund t'i lexoje thellë urrejtjen e shtazës dhe vullnetin e hekurt për të plasur në tokë çfarëdolloj kundërshtari politik, të cilët ia kishin sjellë në majë të hundës me dredhitë dhe tradhtitë e ulëta me fqinjët dhe të huajt. Ai ishte treguar i pashembullt në këtë strategji. "… kush dëshiron të fluturojë, duhet më parë të mësojë të qëndrojë, të ecë, të vrapojë, të tërhiqet këmbadoras e pastaj të vallëzojë. Nuk mësohet të fluturosh duke fluturuar…", thoshte Fridrih Niçe. Por ky lloj zogu kishte mësuar të fluturonte shumë shpejt vetëm duke fluturuar. Ishte bërë ministër i Brendshëm që fëmijë. Jeta e kishte detyruar të fluturonte pa i dalë mirë puplat. Kjo ishte hera e parë që Petraqi e kishte parë Presidentin. Gjithë kohës kishte menduar me vete se Shqipëria kishte mundësi për të zgjedhur njerëz më të kultivuar për ta drejtuar. Me inteligjencën e një djaloshi, nuk arrinte të kuptonte se ku e kishte gjetur forcën një njeri kaq i zakonshëm, sikurse Presidenti, për të dalë në krye dhe për të mbajtur pushtetin.

Ditën e nisjes për në Vjenë, Petraqi nuk do ta harronte gjithë jetën. Teodori ia kishte rezervuar biletën e udhëtimit pranë agjencisë "San Marko". Nisja do të bëhej nga porti i Durrësit. Fillimisht do të mbërrinin në Bari. Aty do të priteshin nga konsulli shqiptar. Të nesërmen do të niseshin

me tren, duke çarë veriun e Italisë, për të mbërritur në Vjenën e largët. Një natë më parë ai arriti të ndahej me Pavlinën, vajzën e Gaqos, rrobaqepësit të njohur të qytetit të Korçës. Gjatë shëtitjes në Shën Triadhë ajo nuk mundi dot t'i lexonte letrën e gjatë që i kishte shkruar. Letrën e shtrëngonte fort së bashku me një fotografi të tyren në duar. Në gjoks e hante meraku që një djalë i përkorë si Petraqi nuk do t'i rezistonte dot dekolteve të Vjenës. Pavlina ishte tetëmbëdhjetë vjeçe. Me Petraqin ishte parë për herë të parë në martesën e motrës së saj më të madhe, Valentinës. Më pas e kishte takuar me të ëmën, një të diel lutjesh, në mëngjes, në oborrin e kishës së Shën Gjergjit. Kur duart ishin shtrënguar, Pavlina ishte skuqur në fytyrë. Nuk kishte pasur kurajën të tërhiqte dorën. Për një kohë të gjatë duart e tyre kishin mbetur të mbërthyera. Ndërsa Petraqit një ndjesi e ngrohtë i kishte përshkuar gjithë trupin. Atë çast ai kishte kuptuar se duart e tyre do të shtrëngoheshin edhe shumë herë të tjera.

Duke e parë njëri-tjetrin në sy kishin hyrë së bashku në kishë. Petraqi, për herë të parë nuk kishte shijuar mrekullitë e kishës, arabeskat e lara me flori, por kultin që i kishte dalë përpara: vajzën me emrin Pavlina, skulpturën hyjnore erotike, e cila ndoshta ishte kjo që kishte krijuar vetë Zotin?! Kur dolën nga kisha, ata u ndanë në oborrin e saj pranë shpatoreve dhe ajazmave të shumta, nën hijen e plepit të famshëm dhe madhështor të kishës. Ai kishte mbetur pa lëvizur për një kohë të gjatë në oborrin e kishës. Në atë oborr ishte rritur. Kisha ishte simboli i qytetit si

për ortodoksët, ashtu edhe për myslimanët. Për ortodoksët ishte e shenjtë, ndërsa për myslimanët një objekt krenarie. Kishte një stil neoklasik dhe një arkitekturë të bukur, ndërtuar me gurë të gdhendur graniti ngjyrë gri, me çati të mbuluar me një llamarinë të veçantë. Bordurat e hatullave ishin plot me elemente dekorative. Ndërsa fasada plot me xhama me ngjyra, e sidomos hyrja në krye të shkallëve ku lartësoheshin një sërë kolonadash të lidhura me njëra-tjetrën, që nëpërmjet harqesh të bukura, rivalizonte edhe majat e kulteve ballkanike. Shën Gjergji ishte një ndër pikat ku lartësoheshin përpjekjet e korçarëve për të arritur Perëndimin, Europën. Për Korçën ishte si katedralja e *Notre-Dame*-s për Parisin, sikurse *Bazilika* e Shën Pjetrit për Romën ose si *Shën Stefani* për Vjenën. Kupola dhe kambanorja e lartë shiheshin plotësisht nga çdo kënd i qytetit.

Me rrugicën e Petraqit ishte shumë pranë. Sapo zgjohej nga gjumi, gjëja e parë që shihte, ishte kambanorja. Sa herë që mendonte për rrugicën e tij, aq më shumë bindej se nuk mund të kishte rrugicë tjetër jo vetëm në Korçë, por në të gjithë Shqipërinë, derë më derë e portë më portë që të kishte kaq personazhe, të cilët kishin sjellë kaq shumë diploma të vlefshme nga vendet e Perëndimit. Në fund të rrugicës, as njëqind metra nga shtëpia e Petraqit, banonte Kryeministri; prapa kishte Aleko Ballaurin, dhe më pas doktor Argjir Kondin. Në të njëjtën rrugicë jetonte edhe Dashamir Zavalani, i cili nuk linte njeri pa përshëndetur kur kalonte para portës. Aty banonin edhe tregtarët

e famshëm, si Rakot e Fundot e këndüar. Më poshtë ndodheshin Frashërllinjtë, Turtujt e Kasimatët.

Pavlina banonte vetëm një rrugicë më larg. Megjithëse i ndante një rrugicë, shiheshin rrallë. Shtëpia ku banonte Pavlina, ishte e re. Kishte një stil venecian dhe e skalitur me gurë graniti. Muret ngriheshin me një gardh të përdredhur hekuri. Prej tij shiheshin tek lulëzonin lule të shumta dhe jargavanë që vareshin në portën e skalitur me gurë të rëndë. Kur rastiste të shiheshin, ajo nuk mundej dot të fshihte përskuqjen që i ndizte gjoksin dhe i shpërthente në fytyrë. Disa herë që ishin shkëmbyer në qoshe të rrugicës, Petraqi i kishte dhuruar trëndafila dhe ajo nuk kishte pasur kurajë t'i refuzonte. Për fat të mirë, ishte mbuluar deri në grykë, kështu që ai nuk mund të shikonte përskuqjen që i mbulonte trupin. Të vetmet raste kur nuk skuqej, ishte kur ai bënte serenatë me kitarë pranë kopshtit të vilës së saj bashkë me Vaso Orgockën dhe Odise Turtullin. Të dy shokët e tij do të studionin njëri për mjekësi në Vjenë, kurse tjetri për ekonomi në Romë. Në këto çaste e mbulonte trishtimi. Mendonte vetëm fustanin e bardhë dhe tufat me lule shumëngjyrëshe. Te Petraqi ajo shikonte gjithçka. Ishte lumturia dhe liria për të. Burri hyjnor dhe tokësor bashkë. Kur e imagjinonte sikur i kishte ardhur nga qielli, nuk do t'i kishte kërkuar Zotit asgjë më shumë. Edhe kur mësues Thomai i Liceut citonte me solemnitet Dostojevskin: "… se po të mos ishte Zoti, e moralshmja nuk do të ekzistonte…", për Pavlinën, edhe sikur Zoti bashkë me moralin të kishte vdekur atë

çast, nuk do të kishte kërkuar kurrë një fat tjetër. Për të mos thënë që Petraqin e adhuronte edhe si fizik. Ai vinte thatim, me një shtat mbi mesatarin, të tendosur dhe me flokë të zinj të dendur. I jepte rëndësi pamjes së jashtme. Kishte një etikë për t'u admiruar, të cilën e kishte skalitur me kujdes i ati, profesori i historisë. Përpos gjithë këtyre, Petraqi përmbushte edhe ëndrrën e fshehur të vajzave korçare, këndonte shumë bukur. Kishte një zë baritoni, që i shpërthente nga thellësia e gjoksit, zë që mund ta gjeje vetëm në Korçë.

Puthja e Petraqit erdhi menjëherë dhe ndërpreu ëndrrat fluturake në atë çast ndarjeje. Pavlinës i mbeti fryma në gjoks. Iu dorëzua e gjitha në një afsh të përzier me melankoli, që as vetë nuk kuptonte se çfarë ishte. Trishtim apo afsh e dridhmë, që nuk do të donte të mbaronte kurrë. Nuk ishte hera e parë që ishte puthur me Petraqin. Ndryshe nga hera e parë, këtë radhë i dukej sikur po e puthte për herë të fundit. Nën dritën e hënës, që binte në degët e lisave të moçëm në Shën Triadhë, ajo kujtoi ditën e puthjes së parë...

Mbrëmja në Lice sapo kishte përfunduar. Askush nuk kishte kërcyer më shumë se ajo. Bashkë me Antonetën dhe Pandorën kishin dalë për t'u përzier me turmën. Ishte dita e karnavaleve. Gjithë mëhalla e qendrës së qytetit kishte dalë për të festuar. Karnavalet festoheshin çdo vit zhurmshëm. Nuk mbetej rini pa dalë të vallëzonte nën tingujt e kitarave dhe të mandolinave. Aty pa të njohur të mëhallës, por edhe të Liceut. Vetëm disa klounë të llangosur me bojëra nuk

arrinte t'i shquante se cilët ishin. Njëri prej tyre, që ishte më i hijshëm, mbante në dorë një kitarë. Ai i përgjigjej në harmoni këngës së njohur korçare të kurbetit, që fliste për një varkë që po nisej në një udhëtim të largët. Një dashuri e lënë në mes, për hir të një emigrimi në Amerikë, në Mekën e korçarëve të asaj kohe. Më pas, pothuaj të gjithë kërcenin dhe shpotitnin njëri-tjetrin në një rrëmujë, që duket një mrekulli vetëm në karnavale. Befas, nën flokët e saj të rëndë ndjeu një dorë të ngrohtë. Në të ftohtin e asaj nate iu duk si një afsh i ngrohtë, i nevojshëm, si ajri që thithte. Nuk arriti as të trembej nga ajo dorë. Ndoshta ishte pikërisht ajo që i kishte munguar. Me instinktin që mund ta ketë vetëm një femër, ndjeu që kjo dorë duhej të ishte e dikujt që ajo e ëndërronte çdo natë. S'pati kohë të mendonte më gjatë. Buzët takuan në një gojë epshore të lëngët, që me ashpërsinë e mjekrës përreth i ndezi gjithë trupin. Vetëm një veprim kaq i nxituar mund t'i kishte dhënë fund dilemës që e kishte munduar aq gjatë. Kitara që mbante në dorën tjetër e kishte tradhtuar befas. Ishte vetë Petraqi që në çdo ditë normale të jetës nuk do të kishte kurajë të bënte atë që vetëm karnavalet ta mundësonin. "Oh, Zot, - mendoi me vete, - ndoshta vetëm për këtë janë krijuar, që të çlirojnë njerëzit nga morali meskin i kohës."

Turma vazhdoi shfaqjen deri në fund të shëtitores. Pavlinës nuk i interesuan më karnavalet. Goditja e puthjes së parë nuk kishte lënë vend të perceptonte gjë tjetër. U kishte bërë shenjë dy shoqeve të saj që të ktheheshin në shtëpi. Nuk kishte përfunduar me kaq. Petraqi bashkë me

dy shokët ishin afruar poshtë ballkonit të shtëpisë dhe kishin kënduar nën dritën e hënës. Nga perdet e dritareve shquheshin qartë kokat e çbojatisura të tre djemve. Këtë radhë nuk kishin kënduar si klounë gazmorë, por me një trishtim që edhe vetë romantikët do t'i kishin zili. Atë natë nuk kishte bërë gjumë. Kishte ndryshuar njëherë e përgjithmonë edhe regjimin e gjumit. Tashmë po fillonte gjumi i ëndrrave dhe i shqetësimeve. Gjumi vajzëror i shqerrës kishte vdekur përgjithmonë.

Një e puthur tjetër e kishte sjellë në vete. Pa dashje e kishte shkëputur nga ëndërrimi. Petraqi i kishte thënë se duhej të ndaheshin. Do të nisej herët në mëngjes. Vetëm një gjë duhej të ruante të sigurt, premtimin për dashurinë që i kishte dhënë. Edhe sikur në fund të botës të humbiste, do ta gjente rrugën për të ardhur tek ajo.

Teodori ishte zgjuar herët atë ditë. Petraqi e kishte bërë gati valixhen që në darkë, bashkë me nënën e tij, Evgjeninë. Gjithë natën ajo i ishte lutur Zotit për të. Ai ishte djalë i vetëm. Ishte hera e parë që largohej nga shtëpia. Meraku i nënës nuk do të reshte derisa të shikonte djalin përsëri pranë saj.

Në Portin e Durrësit ata mbërritën në orët e para të mëngjesit, pas një rruge të gjatë plot me kthesa. Ndarja ishte bërë përpara se të hipnin në bordin e anijes, në një hangar të madh, të përshtatur enkas për udhëtarët. Kapiteni i anijes ishte një shqiptar i ardhur nga Ulqini, me emrin Kurt Ulqinaku. Kishte vite që bënte tregti me portin e Durrësit. Aty pranë, me paratë që kishte bërë nga tregtia,

kishte ngritur një pallat banimi, ku jetonte së bashku me vëllezërit. Tregtia me Italinë kishte dhënë frytet e veta. Nuk e ndërronte Durrësin me asnjë qytet tjetër. Anijen e udhëtimit ia kishte blerë një italiani dhe prej pak kohësh bënte linjën Durrës-Bari dhe anasjellas.

Anija u shkëput nga kalata dhe u zhduk në horizont. Aty ku ka qenë gjithmonë Torra Veneciane, Teodor Harizi, i zhytur në mendime, nuk u largua derisa anija humbi në det. Mes një trishtimi që të lënë ndarjet, iu lut Zotit për mundësitë që i kishte dhënë. Nuk kishin qenë të vogla përpjekjet për të shijuar lirinë, për të bërë biznes, për t'u shkolluar ku të doje, për t'u zgjedhur në qeverisje, për të folur lirshëm gjuhën e nënës. Ishte rritur në Korçë. Që në fëmijëri, mbi kokën e tij kishte pasur dy çekanë. Njëri ishte ai i qeverisë turke që sundonte, kurse tjetri, ai i patrikanës greke. Njëri prej hekuri, kurse tjetri shpirtëror. Kishte qenë aty si një statujë e historisë së vështirë dhe të paimagjinueshme të qytetit të tij. Kishte bindjen se, edhe po t'i bëje një studim të hollësishëm të gjithë historisë botërore, zor se gjeje një të tillë si ajo e Korçës. Kur në Shqipëri ishte shpallur pavarësia, në Korçë lufta me ushtritë fqinje kishte qenë në revanshin maksimal. Kishte luftuar me Perandorinë në perëndim të saj, dhe ishte ndeshur me të gjithë fqinjët. Me sytë e tij kishte parë barbari të mëdha. Kur po fundosej Perandoria e madhe Turke, nuk kishte mbetur ndonjë prej fqinjëve ballkanikë që nuk kishte hyrë në Korçë. Andartët ishin të parët që kishin hyrë brenda në qytet, pasi kishin thyer turqit në Follorinë. Korçën, nusen

e Epirit të Veriut, sikurse e quanin andartët, nuk kishte pasur Zot që mund t'ua hiqte nga mendja. As bullgarët nuk ishin ndalur, kishin hyrë të gjithë në Korçë. Bashkë me serbët dhe malazezët kishin qenë në garë se kush do të digjte dhe vriste më shumë. Garën, natyrisht që e kishin fituar andartët grekë, sepse kishin pasur në aleancë mitropolinë dhe kishën, që e kishte parapërgatitur terrenin kohë më parë.

Në praninë e tij dhe të një grupi gazetarësh europianë, një ushtar grek kishte treguar me mburrje se çfarë kishte bërë në Epirin e Veriut. Se si kishin hyrë në një fshat mysliman, ku pasi kishin vrarë dhe prerë, djegur e vjedhur çfarë u kishte dalë përpara, më në fund, në një shtëpi kishin gjetur brenda dy gra të fshehura. Njëra prej tyre kishte qenë shtatzënë. Fillimisht kishin therur atë që nuk kishte qenë shtatzënë. Më pas, me sfungjinë që kishte pasur në dorë, i kishte çarë barkun gruas së ngratë dhe i kishte nxjerrë foshnjën prej barku. E kishte mbajtur në majë të sfungjisë derisa gruaja kishte dhënë shpirt. Pastaj e kishte flakur krijesën e saj. Kur kishte dëgjuar këto fjalë, i ishte dukur sikur kishte qenë në ëndërr, por kur qimet i ishin ngritur të gjitha përpjetë, kishte kuptuar që nuk ishte në ëndërr. Kafsha që kishte përpara kalonte çfarëdolloj egërsire që mund të ekzistonte mbi tokë dhe nën tokë. Edhe vetë Perëndia duhej të turpërohej nga këto barbari, duke qenë se ishte Ajo që i kishte sjellë njerëzit mbi tokë. Ai kishte qenë aty edhe në maj të vitit 1912, kur vetë princ Jorgoja, i biri i ish-mbretit Konstandin, së bashku me

prefektin e Follorinës dhe disa kolonelë e oficerë grekë, kishin ardhur në Korçë për të nxitur disa grekomanë ortodoksë për të protestuar kundër vendimit të Londrës për mëvetësimin e qarkut të Korçës nga Greqia. "Bashkim ose Vdekje", kishin thirrur një grusht shqiptarësh të paguar, duke shpresuar me naivitet që mund të bindnin Europën përkundër vendimit të saj.

Ai e njihte mirë delirin e grekëve, sepse edhe vetë, pa u formuar mirë si burrë, i ishte dashur të ndiqte shkollën fillore atje. I ishte dukur gjithmonë e neveritshme dhe e rrezikshme se si grekët, që në djep, duke pirë qumështin e nënës, "pinin" edhe mësimet e historisë së madhështisë së Greqisë së lashtë, me shpresën se ata do të bëheshin më të madhërishëm sesa të parët e tyre. Ortodoksia për ta ishte e lidhur dhe e pandarë prej kombit grek. Çdo grek i mirë duhet të jetë ortodoks dhe çdo ortodoks duhet të jetë grek. Duke fetishizuar këto konfeksione fetare, grekët e kishin katandisur politikën deri në atë absurditet saqë edhe vetë besonin se, përveç Rusisë, gjithë ortodoksët e tjerë të Perandorisë Osmane dhe të të gjithë botës janë dhe, në mos janë, duhet të jenë grekër. Forca që e mbante të ngrehur këtë zemrek ishte patrikana greke e Stambollit ose Ministria e Jashtme e Greqisë. Duke u pompuar me megaloidenë dhe duke menduar se sa larg do të shkonte Greqia, i kujtonte gjithmonë takimin e filozofit të njohur, Diogjenit, me astronomin e Greqisë së Vjetër. Ai lavdërohej se dinte gjithë yjet ku janë dhe ku s'janë, dinte Diellin dhe lëvizjet e tij, por për fat të keq atje ku ai ecte gjithë ditën,

kishte ngritur kokën që të vështronte në qiell, dhe kishte rënë në një pellg të madh. Diogjeni i madh, pasi e kishte parë, i kishte thënë: "Zotrote, di se ç'ka në qiell dhe nuk di se ç'ke para këmbëve të tua". Teodori e dinte mirë se çfarë kishte përpara tij, por edhe ato që ndodheshin prapa tij, sepse nuk ka ndonjë vend në botë që të ruajë mitet sikurse ruhen në Shqipëri.

Mitet i ishin dashur, sepse askush nuk i kishte lënë të shkruanin në gjuhën e tyre. Ishin shumë pushtues që kishin hyrë. Nuk kishin lënë gjë pa grabitur dhe vrarë, por ja që mitet dhe legjendat nuk mundën t'i grabisnin dot. Sa më shumë varfëroheshin shqiptarët, aq më shumë dilnin ato në pah. Sa më shumë dhunoheshin nga të gjithë armiqtë bashkë, aq më shumë mitet e vjetra ndriçonin rrugën e shpëtimit dhe të konsolidimit të vlerave. Ai e dinte mirë se nuk ishin të paktë ata burra të shkëlqyer, që i kishin ndryshuar faqen botës mbarë dhe që qenë shqiptarë. Gjuhën e nënës kishin gjuhën që flasin sot shqiptarët. Kur filozofi dhe historian grek Plutarku, thoshte që Aleksandri i Madh iu foli shokëve në gjuhën maqedonase, dhe kur mbreti Pirro, duke u ndeshur me romakët, u foli shokëve të tij në gjuhën maqedonase ose epirote, cila do të qe kjo gjuhë përveçse ajo shqipe? Si mund të ishte gjuhë bullgare, serbe apo vllahe kur në ato kohë nuk kishte ardhur në ato vise asnjë prej kombeve të sipërpërmendur? A mund të thoshte njeri që gjuha maqedonase do të ishte një nga dialektet e gjuhës greke, kur dihej që këto dialekte ishin katër: atike, eolike, jonike dhe dorike? Epirotët e vjetër

kurrë ndonjëherë nuk kanë qenë grekër. Pirroja i madh fliste greqisht duke qenë se ajo gjuhë ishte më shumë e lëvruar. Edhe vetë Aristoteli nuk kishte shkruar në gjuhën e tij, e cila ishte shqipja, por kishte shkruar në atë greke, që ishte në atë kohë e qytetëruar.

I kishin vërshuar shumë mendime në kokë, dhe ndonjëherë emocionet e trishtimit të ëmbël, që vijnë nga nostalgjia, janë më të rënda sesa trishtimi i hidhur, që vjen nga humbja. Në përhumbjen e mendimeve të tilla, Teodori u ndal në shëtitoren e Durrësit, tamam aty pranë ku flinte në letargji amfiteatri i pazbuluar. Në klubin e parë që i doli përpara, u ul në një tavolinë pranë dritares dhe mori një birrë, në pritje të makinës për t'u kthyer në Korçë. Përballë kishte restorante dhe dyqane të shumta, të mbushura me mall cilësor dhe përplot me njerëz që kërkonin ta jetonin jetën. Gjallëri nuk kishte vetëm në Korçë. Edhe Durrësi rivalizonte me sukses me epërsinë që mbart një qytet-port nga më të rëndësishmit në vend. Ndoshta anija do të kishte shkuar disi larg, por jo aq larg sa kishin shkuar mendimet e Teodorit, teksa shijonte një birrë italiane dhe përpiqej të përmblidhte kujtimet e tij. Nuk donte kurrsesi të bënte orakullin, por ndjenja e frikës nuk e lëshonte asnjëherë. Nga natyra ai nuk ishte pesimist, por sa herë që shikonte gjithë këto zhvillime të menjëhershme anembanë, e mbërthente një ndjenjë pasigurie, që kjo kohë e bukur zhvillimi nuk do të zgjaste shumë. Shqipëria, vendi që ai e kishte pjesë të trupit, do t'i kthehej fatit të mëparshëm. Mjaft të prisheshin pak ekuilibrat politikë në Europë dhe

vendi më i vogël dhe i pambrojtur do t'i nënshtrohej fatit të më të fortit të radhës. Nuk kishte asnjë mundësi për ta mbrojtur i vetëm. Herë pas here, me një zë të brendshëm, që ndoshta dëgjohej edhe nga ata që mund të ishin pranë, thoshte me vete: "O Zot mbroje!". Gjithsesi, vetes i jepte kurajë. Me forcën e arsyes nuk donte të mendonte për të shkuarën. Nga ato që shikonte, çdo ditë bindej se ato ditë të tmerrshme kishin marrë fund përgjithmonë. Në të vërtetë, ditë të mbara po vinin përpara. E ardhmja tashmë kishte hyrë në shina të sigurta. Vetë Fuqitë e Mëdha kishin vendosur për fatin e Shqipërisë.

Kujtimet për të shkuarën mbeteshin vetëm të shkruheshin nëpër libra. Si profesor i historisë tashmë kishte shkruar me kujdes më shumë se dy vëllime të historisë së Shqipërisë, duke përshkruar me kujdes të gjitha masakrat që ishin bërë mbi shqiptarët nga fqinjët, kryesisht ata grekë. Librat ishin botuar edhe në Francë. Kontributin e kishte dhënë në mënyrë të pandërprerë në shtypin e përditshëm dhe në gazetën "Atdheu", që ai drejtonte si kryeredaktor. Nuk i kishte pëlqyer asnjëherë të shiste patriotizëm. Masakrat që ishin bërë mbi shqiptarët, i kishte përshkruar më qartë se ato që mund të shfaqen në film. Diplomatët francezë në Shqipëri i kishin thënë hapur se e ardhmja e tij si historian nuk do të kishte ndriçimin e duhur. Klanet e politikës do ta pengonin gjithmonë që ai të shprehte të vërtetën. Shkrimet e tij kishin lënë mbresë të thellë në zemrat e patriotëve të vërtetë. Politikanët shqiptarë ishin viktima të mentalitetit anadollak turk. Për

ata e vërteta ishte sikurse femra e bukur, që nuk mund të dilte lakuriq nëpër qytet. Sugjerimet e miqve të huaj i kishte dëgjuar me mosbesim. Kishte mbizotëruar instinkti i vendit të lindjes, që nuk mund të zëvendësohej me asgjë tjetër. Koha i kishte dhënë të drejtë.

Ishte i kënaqur me jetën. Vendimin për të jetuar në Shqipëri e kishte marrë pa hezitim. Asnjëherë nuk e kishte humbur besimin që ditët e vështira kishin kaluar. Brenda një kohe të shkurtër vendi kishte bërë hapa të mëdhenj. Për herë të parë, që nga koha e Skënderbeut, vendimet merreshin nga shqiptarët. Falë Zotit, ekonomia kishte ecur mbarë dhe mirëqenia vërehej dukshëm gjithkund. Personalisht ishte i kënaqur, por, për dreq, kjo e shtynte prapë në të kundërtën, aq sa shpesh mendonte: "A ishte kjo lumturi e përkohshme apo do të zgjaste përgjithmonë?!". Kësaj dileme nuk kishte mundur t'i jepte dot përgjigje. Në fund të fundit, ishte martuar me një vajzë që e kishte dashur dhe që vinte nga familjet e sërës në Korçë. Drejtonte gazetën e qytetit dhe ishte në vëmendjen e të gjithë elitës kulturore dhe politike të qytetit. Kishte ndërtuar një shtëpi në zemër të qytetit pranë kishës së Shën Gjergjit, dhe ishte bërë me dy fëmijë. Çfarë mund t'i kërkonte jetës më shumë, duke e ditur që, kur kërkon shumë, do të humbasësh edhe ato që ke. Gjithsesi, nuk e kishte humbur asnjëherë optimizmin, edhe kur në Parlamentin Shqiptar kishte kontradikta të mëdha, edhe kur politika përulej ndaj atyre që jepnin tonin e politikës ndërkombëtare, duke i parë këto si normalitet edhe për vendet e Perëndimit. Kur

ndeshej në rrugë me grekomanë, të cilët u përdorën keqazi nga andartët, i përshëndeste me mirësjellje. Mendonte që ishin pjesë e vobekësisë dhe e dobësisë njerëzore, që shfaqen dukshëm në vendet e pushtuara dhe pa autoritet shtetëror. Njërin prej tyre, madje, Kosta Milon, e kishte edhe në gazetë. E kishin marrë aty me propozimin e mitropolitit. Ky gazetar shiste patriotizëm të tepruar, aq sa i ishte dashur të ndërhynte shpesh në shkrimet e tij, sepse deformonte informacionet që jepte gazeta. Edhe për pavërtetësi të tjera që shkruante, ai e kishte paralajmëruar për ta larguar. Sa herë që bëhej gati ta nxirrte nga gazeta, mitropoliti i shfaqej në derë dhe i lutej ta mëshironte se kishte katër fëmijë. Jeta dhe kultura që përfaqësonte, e kishin mësuar që të ishte tolerant. Këtë bënte edhe me Kostën, të cilit vendosi t'i jepte dorën. Shumë gjëra të tilla i shikonte si pjesë të dobësisë së karaktereve njerëzore. Ishte i kënaqur që e përgjithshmja shkonte mirë. Ekonomia ishte përmirësuar dukshëm. Kudo kishin hyrë bizneset e huaja. Shumë vendas bënin biznes jashtë. Njerëzit hynin e dilnin lirshëm nga Shqipëria, madje së fundi qeveria kishte nënshkruar edhe një marrëveshje me qeverinë e Amerikës për heqjen e vizave. Shkollat shqipe ishin përhapur gjithkund. Në vend mbizotëronte rendi dhe normaliteti. Në këtë atmosferë ndërgjegjja e tij funksiononte pozitivisht edhe në punë e në familje. Ky ishte përjetimi i Teodorit në ndarjen e trishtë nga i biri.

* * *

Udhëtimi me anije nuk zgjati shumë. Kërcitjet e trarëve të saj, gjatë orvatjes për t'u parkuar në mol, i kishin nxjerrë gjumin Petraqit. Porti i Barit ishte shfaqur i tëri nga dritarja e anijes dhe ai kishte nxituar për të dalë në bord. Mëngjesi ishte i freskët e me një qiell të pastër. Ishte hera e parë që udhëtonte jashtë. Nuk ngopej duke përpirë me sy atdheun e etruskëve. Nga bordi i anijes nuk shikonte më shumë se disa magazina mallrash, por dijet prej kulturës së vjetër romake i ishin ngulitur thellë në kujtesë që në Liceun e Korçës. Adhurimi që kishte për rrënojat antike dhe stilin unik të Mesjetës përbënte për të një dashuri idilike. Edhe kur mendonte që kishim qenë përreth një mijë vjet nën sundimin e Romës, nuk gjente dot qasjen e duhur. I ishte dashur të mendonte që ata romakë që kishin ardhur në Iliri ose kishin qenë dembelë, ose nuk kishin dashur ta përhapnin kulturën e tyre. E konsideronte një fatkeqësi që pesëqind vjetët e sundimit të Perandorisë Turke kishin qëlluar të fundit. E urrente fatin e keq që, të paktën, ata dreq pesëqind vjet të fundit, të kishin qëlluar me Perandorinë Romake. Nuk e pranonte dot faktin që vendit të tij të zemrës i mungonte ngado stili i Mesjetës. Dukej si një grua plakë, e lodhur dhe e shfrytëzuar nga jeta, që mizoritë nuk e lejuan të lindë. Me qëllim i hoqën edhe organet gjenitale, që të mos provonte asnjëherë afeksionin riprodhues.

Në portin e Barit kishte dalë për t'i pritur konsull Rifat Bekteshi. Ai i përshëndeti që nga larg, me një kapelë që e mbante në dorë. Sapo zbritën shkallët e anijes, konsulli i rroku në qafë, ashtu sikurse dinë të bëjnë vetëm shqiptarët. Nëpunësit e doganës italiane i panë me çudi këto përqafime viganësh, duke u habitur që, megjithëse ishin aq pranë, e kishin humbur tërësisht atë sinqeritet njerëzor të takimit, duke u përshëndetur në një formë të shpëlarë të stilit të modernitetit njerëzor. Nuk u vonuan aspak në kryerjen e formaliteteve. Pasi hëngrën një pjatë spageti pranë stacionit të trenit, u nisën me të shpejtë me trenin e drekës për në Romë. Barin e kishin kundruar aq sa kishin pasur mundësi, rrugës për në stacionin e trenit, si dhe nga dritaret e restorantit të vjetër. Duke menduar që përpara i priste Roma, nuk ndienin asnjë lodhje. Prisnin me padurim sa të mbërrinin. Në Romë do të qëndronin një natë në hotel "Savoja", pranë Fontana di Trevi-t. Më pas do të përshkonin me tren veriun e Italisë me destinacion të fundit Vjenën. Petraqi kishte zënë vendin pranë dritares, me qëllimin e vetëm që të mos i shpëtonte ndonjë gjë nga arti dhe magjia e pashlyeshme e këtij vendi. Herët, pa vendosur për të ndjekur drejtësinë, ëndrra e tij, përpos kitarës, kishte qenë arkitektura. E ku më mirë se në Itali mund ta realizonte këtë profesion. Nuk kishte menduar kurrë që të fitonte me këtë profesion. Vetëm që të sillte modele të mrekullueshme të stilit të Mesjetës, edhe në Shqipëri, në atë plakën e kërrusur, që kohë më parë, sikurse kishte dëgjuar nga gjyshja, kishte qenë një nuse

shumë e bukur, por e rrëmbyer dhe e gremisur nga zilia e shëmtuar e perandorive, nuk kishte mundur të rilindte.

Treni ecte me shpejtësi dhe përshkonte tokën e etruskëve. Shumë më shpejt se treni ecte fantazia e Petraqit. Kishin orë që udhëtonin. Ende nuk kishte ndërruar një fjalë me shokët që e shoqëronin. Nga dritarja e trenit vështronte me inat zhgënjimin. Të paktën, ndonjë rrënojë të vjetër nuk kishte mundur të haste në këtë udhëtim të mërzitshëm. Udhëtimit po i vinte fundi. Kudo i dilnin përpara shtëpi popullore dhe stacione treni, të mbushura me njerëz, që në brendësi reflektonin varfëri. Nuk donte ta pranonte! Gjithsesi, goja i ishte kyçur për të pyetur konsullin. Kishte dëgjuar se para se të vinte në përfaqësi, kishte qenë mësues i shquar historie, njeri erudit dhe njohës i mirë i latinishtes, përkthyes i disa librave nga latinishtja.

U dëgjua bilbili i konduktorit. Konsulli i udhëhoqi që të zbrisnin në Romë. Në shkallët e stacionit kishte dalë për t'i pritur Ahmet Resuli, diplomat i ambasadës. Megjithëse po afronte mesnata, qyteti kishte gjallëri. I gjithi ishte i mbushur me drita. Edhe pse natë, vetëm një i verbër mund të mos e shihte madhështinë. Ajo që pa, ishte e paimagjinueshme. Një histori e tërë që kishte frymëzuar një botë të qytetëruar. Nga të katra anët i shfaqeshin ndërtesa dhe rrënoja të vjetra. I dukej sikur ishte i veshur me parzmore, i hipur në një karrocë me kuaj dhe me shpatën e legjionarit të lashtë në dorë teksa përshkonte tërë polisin e Romës. Vetura e ambasadës përshkoi qendrën e qytetit. Petraqi qortonte miopinë e tij. Sa mirë që nuk kishte folur

dhe zhgënjimin e nxituar t'ia kishte shfaqur konsull Rifatit rrugës për në Romë.

* * *

Ishte mëngjesi i një dite shtatori. Dielli kishte hyrë në çdo rrugicë të Romës. Nga restoranti i hotelit ku po hanin mëngjesin, Petraqi po mendonte për këtë emër të magjishëm që ishte bërë qendra e kulturës botërore. Për 100 vjet para lindjes së Krishtit, dhe 400 vjet pas lindjes, ishte qyteti më i madh në botë. Kishte dëgjuar që në këtë qytet, në lavdinë e tij, nuk njihej varfëria, falë ekzistencës së Annona-s ose perëndeshës së bollëkut. Me anë të furnizimit me grurë i garantonte mbijetesën qytetarëve të varfër. "O Zot i madh, sikur ta kishim edhe ne një të tillë në Shqipëri!", mendoi me naivitet fëminor Petraqi. Mendimet ia ndërpreu diplomat Ahmeti. Ai i shpjegoi se vinte nga një familje juristësh. I ati kishte studiuar për jurist në Vjenë. Me një ton miqësor i porositi studentët që, për çdo shqetësim që do të kishin, të mbanin kontakte të vazhdueshme me ambasadën në Vjenë. Studentët shqiptarë në Itali ishin një përvojë e veçantë. Qeveria italiane, që akordonte bursat, nuk kishte vit që nuk e thërriste ambasadën për të dekoruar më të spikaturit. Në vazhdim të predikimit dashamirës, ai i porositi që, nga ana tjetër, të tregonin kujdes me vështirësitë për t'u përshtatur me realitetin modern që do të ndeshnin. Në shumë raste ai prodhonte inferioritetin negativ.

- Kemi bërë gjithmonë diplomaci me Perandorinë Austro-Hungareze, - vijoi Ahmeti. - Kemi qenë ndër më të preferuarit për të. Ndihma ka qenë e veçantë. Kultura që kemi marrë, përbën një bazë të rëndësishme në formimin e administratës së re. Ajo është edhe një frymë e shëndoshë dhe solide kundër anadollakëve turq, - shpjegoi ai. - Është një shans i madh që kultura që do të merrni aty të vijë në Shqipëri. Mos harroni që shqiptari, kudo ku ka shkuar, nuk është turpëruar. Përshtatuni me kujdes, mësoni me përulje gjuhën dhe kulturën e latuar të atij vendi. Nga ana tjetër, mbani në konsideratë fjalën e vjetër që "shqiptari përkulet, por nuk thyhet kurrë", - vijoi ai duke qeshur. Nuk ishte hera e parë që Petraqi e dëgjonte këtë. A nuk ishte gjyshi i tij, që e përsëriste rast pas rasti, sa herë që fatet e përplasnin shqiptarin nëpër udhëkryq? A mund të kishte komb në botë që të ishte sunduar nga të huajt më shumë se 2500 vjet me radhë dhe të kishte ruajtur tërësisht identitetin, më mirë se shqiptarët?

Mendimet përsëri ia ndërpreu diplomat Ahmeti. Ai u tha që duhet të ngriheshin menjëherë. Treni për pak nisej. Duhej të nxitonin për në stacion. Rruga ishte e mbushur me njerëz a thua se gjithë Roma do të udhëtonte atë ditë me tren. Petraqi do të dëshironte që atë ditë në stacion të mos kishte këmbë njeriu. Përpiqej që vetes t'i jepte kurajë, por nuk e kishte menduar që ishte aq i ndjeshëm. Ndarja do të bëhej në stacion. Nuk donte që të shfaqej i dobët e i papërmbajtur para njerëzve të tjerë. Koha ishte e shkurtër.

Ai, bashkë me Vaso Orgockën, do të nisej për në Vjenë, ndërsa Odisea do të qëndronte në Romë. Ishte dita e parë që ndaheshin që kur kishin qenë fëmijë. Ishin rritur në oborret e njëri-tjetrit. Prindërit e tyre ishin miq të hershëm. Banda e tri zërave të paarritshëm nuk do të funksiononte më. Tingujt e kitarave dhe zërat baritonë në mbrëmjet e errëta nuk do të dëgjoheshin për një kohë të gjatë. Ndoshta edhe kurrë, sikur fati t'i mbante këtej nga i kishte hedhur. Vetëm ai dhe Odisea ishin të fejuar. Odisea i përkiste një prej familjeve më të pasura të Korçës. Alqi, i ati i Odisesë, kishte kohë që bënte tregti me Selanikun, Stambollin dhe vende të tjera. Për kohën, ndoshta, ishte një nga tregtarët më të pasur të vendit. Për ironi të këtij fakti, sa më i pasur ishte i ati, aq më indiferent ndaj pasurisë së tij ishte i biri. Luftën ndaj pasurisë e kishte shpallur herët, që në adoleshencë. Në ndryshim nga vëllai i madh, asnjëherë nuk e kishte tërhequr tregtia e të atit. Nuk kishte shkelur as për të parë aktivitetin që kishte emër të madh edhe përtej Shqipërisë. Ishte bërë anëtar i shoqërisë patriotike "Vatani" dhe i ishte afruar brenda një kohe të shkurtër mandolinës kryesore të bandës. Që fëmijë kishte ndjekur bandën e qytetit, derisa ajo përfundonte udhëtimin e saj debutues nëpër qytet. Këngët patriotike, dhe kryesisht ato të dashurisë, i interesonin më shumë se çdo gjë tjetër.

Në korin e bandës ishte njohur me Antonetën, vajzën e solistit të grupit. Ajo qëndronte në krah të tij si mandolinë e tretë. Ishte femra e vetme e korit. Në qoftë se në bandën e korit Antoneta renditej si mandolinë e tretë, për nga

bukuria mbante vendin e parë në qytetin e ftohtë. Kishte mbetur jetime që katër vjeçe. Të ëmën pothuajse e kishte harruar fare. Marko Matraku ishte kujdesur për krijesën e dalë nga dashuria e tij e vetme dhe ia kishte dalë ta rriste me një dashuri të pazakontë. Nuk ishte martuar kurrë pas vdekjes së gruas. Jetës së tij i jepnin kuptim dy dashuri, ajo për Antonetën dhe ajo për korin e "Vatanit", që çdo ditë, falë përkushtimit të tij, shndërrohej në krenarinë e qytetit. Odisesë nuk do t'i ishte dashur shumë kohë për të fituar dashurinë e Antonetës, sikur të mos ishte nëpër këmbë i ati, që i qëndronte pranë në çdo sekondë të jetës. Nga ana tjetër, Antoneta, sa më shumë e njihte Odisenë, aq më shumë kuptonte se dashuria e tij ishte e pastër. Në zemrën e tij kishte hapësirë më të madhe për dashurinë se çdo djalë tjetër. Kjo hapësirë ishte krijuar nga përjashtimi që ai i kishte bërë me vetëdije pasurisë.

- Është koha t'i shtrëngojmë dorën njëri-tjetrit, - tha me solemnitet diplomat Ahmeti, pasi treni po bëhej gati të nisej. Të tre u shtrënguan kokë më kokë. Pas përqafimesh sikurse ata që shkojnë në luftë, dhanë fjalën që do të ktheheshin aty ku kishin nisur rrugëtimin dhe ku i kishin rrënjët, edhe sikur t'u duhej të humbitnin gjithçka nga bukuria e jetës.

Kur hipën në platformë dhe dolën në dritaren e trenit, ndarja qe ende më e rëndë. Aty e ndjenë, në të vërtetë, që ishin ndarë. Odisea qëndronte në këmbë i mpirë. Rrëketë e lotëve i kishin mbuluar mjekrën. Petraqi me Vason, pa e mbajtur dot ngashërimin, përshëndetën me duar, pa

pushim, deri në zhdukje, siluetën e mikut më të mirë që po e braktisnin pa dëshirë.

* * *

Kur treni hyri në stacion, dielli po tentonte të dilte. Përskuqja e atij mëngjesi ngjante më shumë me muzgun sesa me lindjen e ditës së re. Ajri i ftohtë u ndje menjëherë sapo zbritën. Petraqi mendoi se përshtatja me klimën në Vjenë do t'i linte vendin vetëm përshtatjes së vështirë me gjuhën dhe me kulturën, pasi ajri i ftohtë iu duk i njëjtë me atë të qytetit të lindjes. Të atij qyteti ku dilje nga një shtëpi e ftohtë, hyje në një shkollë të ftohtë e më tej në një klub të ftohtë, më pas përsëri në një shtëpi të ftohtë, por ama me njerëz të ngrohtë... Njerëzit që sapo pa, iu dukën indiferentë dhe të ftohtë, ndërsa vajzat dukeshin si nimfa, me lëkurë të bardhë dhe të tendosur. Po t'i vështroje në sy nuk mund të arrije t'u merrje përqendrimin. Nuk binin në siklet si vajzat që kishte parë andej nga vinte. Ato vinin më të plota se vajzat e mëmëdheut dhe më të gjata. Për aq sa shikonte, do t'i duhej një fizik bajlozi dhe një mendje titani për t'i sjellë në afsh këto nimfa të mermerta.

Këto gjëra po i vinin në mendje në atë libidon e fshehtë që thotë Frojdi, në atë arketipin e botës së errët të instinkteve që ekziston te çdo mashkull, duke kundruar pasagjerët e përgjumur në stacion që, në ndryshim nga ai i Romës, ishin më të kontrolluar dhe më të qetë. Sidoqoftë, ky mëngjes do të quhej dita e parë në Vjenë. Atij, bashkë

me Vason, do t'u duhej të përballeshin me gjëra të tjera në këtë destinacion studentor. Me aq pak sa po shikonte, po kuptonte menjëherë se përpara do të kishte një luftë të madhe, për të ndarë atë se për çfarë kishte ardhur, dhe atë që do t'i afronte bota e panjohur më parë prej tij, në të cilën ai tashmë sapo kishte hyrë.

Shtëpia ku do të qëndronin, ishte në Stefan Platz, pranë katedrales së njohur të Shën Stefanit. Nga dritaret mund të shikonte qartë kulmin e kambanores. Ishte më shumë se i mrekulluar. Çdo mëngjes do të zgjohej, sikurse në vendin e origjinës, nga ku shikonte kambanoren e kishës së Shën Gjergjit. Apartamenti ishte i vogël e i mobiluar lehtë, me një stil të Mesjetës. As në Romë dhe askund tjetër në botë, besonte ai, nuk mund të kishte kaq ndërtesa me atë stil, të cilat i kishte ëndërruar dhe dashur aq shumë. Shtëpiza ku do të qëndronte me Vason ishte në pronësi të një çifti të moshuarish. Ata nuk kishin fëmijë. Për gjithçka që do t'u duhej, do t'i referoheshin në atë fillim të vështirë opinionit të tyre. Në prezantimin e parë, dukeshin mikpritës dhe simpatikë. Ata i ftuan për të parë edhe konakun e tyre. Ishte i mbushur plot me këpucë në punim e sipër. Të dy miqtë porositën, pa u menduar dy herë, këpucë që dukeshin më shumë si të pikturuara, sesa si të vërteta. - Me këto këpucë mund të zgjosh gjithë Korçën nga gjumi, - tha Vaso. - Edhe kalldrëmet do të trembeshin nga sholla e trashë, - qeshi me gjithë zemër ai. Çifti i këpucarëve vazhdonte të tregonte konakun e vogël ku qëndronin vetë. Ai ishte edhe më i vogël e i thjeshtë sesa ai që u kishin

vënë atyre në dispozicion. Aty nuk dukeshin gjurmët e këpucëve. Në ndryshim nga konaku i zanatit, dukej sikur ambientet i ndanin dy botë të ndryshme. Gjithçka të linte të kuptoje shpirtin mikroborgjez të të moshuarve. Me rropatjen e jetës së përditshme, sillnin këpucë të vërteta dhe me këtë zanat të vjetër kishin bërë edhe një pronë të vogël, që e jepnin me një qira simbolike.

Fakulteti Juridik do të ishte ndarja e parë me Vason. Nga distanca me shtëpinë, Petraqi ishte më i favorizuar, sepse universiteti ndodhej në qendër, pranë shtëpisë, ndërsa Fakulteti i Mjekësisë ishte më larg. Vasos do t'i duhej të dilte më parë nga shtëpia për të mbërritur në orar. Dita e parë e shkollës nuk ishte dhe aq romantike. Petraqi nuk dinte qoftë edhe një fjalë të vetme gjermanisht. Ai iu bashkua një grupi të madh të ardhurish për studimin e gjuhës. Ata ishin të gjithë djem. Mësimi i gjuhës do të ishte një karantinë e vërtetë. Përshtatja me ushqimin dhe me punët e jetës së përditshme, po ashtu. Njohuritë e tij mbi greqishten e vjetër nuk bënin asnjë punë aty. Sfida ishte përpara, përndryshe turpi do ta ndiqte gjithë jetën dhe nuk mund të kthehej më në qytetin e lindjes. Pedagogu i gjuhës ishte një vjenez i vjetër në moshë. Kishte një mjekër të bardhë dhe shëmbëllente më shumë me babagjyshin e Vitit të Ri, sesa me personin që do t'iu mësonte gjuhën për një vit të tërë. Ai shqiptonte në një theks të ashpër dialektin e *bairischen*-it të gjuhës gjermane, që flitej nga pjesa më e madhe e popullsisë së përbërë nga shumë etni. Vetëm kur kaloi disa vite studimi në Vjenë, Petraqi mësoi se fakti që

në Austri kishte një duzinë me etni, nuk kishte të bënte fare me atë që, për të pasur paqe, ekuilibër dhe qetësi, duhet të jesh një popull homogjen. Përndryshe do të kishte pasur paqe dhe ekuilibër më tepër në vendin e origjinës, në të cilin më shumë se në çdo vend tjetër, shqiptarët ishin shumicë pothuajse absolute. Mësimi i gjuhës do të ishte një rit i përditshëm, përpara se ai të hynte në rrugën profesionale. Shokët e kursit vinin kryesisht nga vendet e Ballkanit. Ajo që i binte në sy ishte se, gjatë pushimeve të shkurtra, ata mblidheshin bashkë dhe merreshin vesh në gjuhën e tyre. Petraqi mbetej vetëm. Shkak nuk bëhej pamundësia për të ndërtuar miqësi, por gjuha shqipe, e cila nuk përngjasonte në asnjë pikë me ato sllave. Nuk e kishte menduar këtë më parë?! Vetëm kur u ngjit në vitet më të larta në universitet dhe në grup ishte me shokë vjenezë e kuptoi shkakun që e tërhiqte më tepër me Perëndimin sesa me Lindjen. Kjo ndodhte edhe me shqiptarë të tjerë. Natyrisht që nuk ishte një rastësi. Kishte shkaqe të thella historike dhe gjeografike. Sidoqoftë, Petraqi mbante marrëdhënie të mira me të gjithë.

Në një nga ditët kur po dilnin nga mësimi, ai po bënte rrugën me Mirko Bogdanoviçin. Ai ishte një nga djemtë më të sjellshëm të kursit. Nga shokët e tjerë kishte mësuar se Mirkoja rridhte nga familja e Karagjogjeviçëve, të cilët kishin ndihmuar në mënyrë të hapur prijësin për të hyrë në Shqipëri, pas dështimit të qeverisë së Fan Nolit dhe pamundësisë së njohjes së saj pothuaj nga të gjithë qeveritë e vendeve demokratike. Mirko ishte një student

i veçantë, me një frëngjishte të përkryer, falë së cilës ai mund të merrej vesh me të. Ishte pak teorik dhe vinte më i përkorë se studentët e tjerë. Qe studenti më i gjatë i kursit, por për hir të së vërtetës vinte, edhe nga mendja, më i gjatë. Rrugës së kthimit për në shtëpi, pikërisht aty ku zgjatimi i Stefan Platzit formon hark dhe kisha e mrekullueshme e Shën Stefanit fillon të fanitet, ai i tha Petraqit se kishte pasur rastin të takonte në shtëpinë e gjyshit prijësin e shqiptarëve. Ai i kishte mbetur në kujtesë si njeriu me armë, duke qenë se, në rastet që e kishte parë, mbante armë në brez, a thua se në atë vizitë kishte ndër mend të zhvillonte ndonjë aksion lufte. Petraqi miratoi Mirkon dhe me çiltërsi i tha se prijësi nuk përbënte aspak elitën e politikanëve shqiptarë. Koha kërkonte luftëtarë në vendin e tij dhe në këtë fushë ai kishte traditë fisi. Para se të ndaheshin, Mirkoja i ftoi për një çaj bashkë me Vason, të cilin ai e kishte njohur në një ballo të zhvilluar në operën e Vjenës, në shoqërinë e dy miqve të tij.

Kur mbërriti në shtëpi, gjeti Vason, i cili po e priste të dilnin bashkë për të blerë kostumin për në mbrëmjen e Krishtlindjeve. Ishte hera e parë që ata do të festonin Krishtlindjet larg shtëpisë. Në Vjenë kishte filluar i ftohti. Për hir të së vërtetës, nuk ishte më i egër sesa i Korçës. Vinte më i thatë, por ajo që e bënte më të acartë atë të vendit të lindjes, ishte fakti se ai ishte më i lagësht. Shpesh shoqërohej edhe me një erë, që të futej në thellësi të kockës. Vigjiljet këtu ishin më të veçanta. Zbukurimet kalonin çdo imagjinatë. Ajo që i jepte më shumë veçanti, ishte fakti se

fillonin më herët. Në fund të nëntorit, zor se gjeje ndokënd që nuk e kishte zbukuruar dhe veshur me kurorë bredhi biznesin apo shtëpinë. Nga ana tjetër, në qoftë se në Korçë ditën më të veçantë të vitit të gjithë ndërronin vizita, këtu ajo ditë ishte më e qeta e vitit. Të gjithë mbylleshin nëpër shtëpi dhe festonin në mënyrë familjare. Qyteti vdiste dalëngadalë. Gjallëri kishte vetëm natën duke u gdhirë Krishtlindjet. Të gjithë njerëzit dyndeshin nëpër kisha, ndërsa të rinjtë mbushnin baret dhe restorantet e qytetit. Të nesërmen të gjithë mbylleshin nëpër shtëpi. Festonin në skutat e tyre të ngrohta, a thua se ishin të ndarë përjetë nga të gjithë njerëzit përqark dhe ishin betuar që të mos dilnin ndonjëherë nga shtëpia, çfarëdo që të ndodhte në botën që i rrethonte. Edhe dyqanet ishin të mbyllura. Nuk kishte rast të gjeje qoftë edhe një të vetëm të hapur për të mbaruar ndonjë nevojë të ngutshme. Ky ishte informacioni që Vasoja kishte marrë nga qiradhënësit e mirë Fritz dhe Rosalina. Ata ishin bërë si prindër për ta. Fraku edhe papijoni duheshin blerë sa më parë për të qenë gati për t'i veshur në ceremoninë e Krishtlindjeve. Festa do të zhvillohej në pallatin e famshëm perandorak të Habsburgëve.

Ishte hera e parë që kishin veshur frak. Të dy bashkë po e ndienin këtë tjetërsim. Ecnin si mbi gjemba. Fillimisht do të hynin në kishën e Shën Stefanit. Aty gjetën me dhjetëra njerëz që kishin zënë radhën për të hyrë në kishë. Pasi ndezën qirinjtë dhe bënë lutjet e zakonshme, morën rrugën për në pallat. Hyrja qe shumë solemne. Çdo çift

parakalonte i kapur për dore, në praninë e muzikës dhe të duartrokitjeve. Vetëm kur hynë aty, morën vesh se të vetmit persona që nuk kishin damë, ishin ata të dy. Që prej vitit 1918, pas vdekjes së Franc Jozefit, pallati ishte kthyer në muze. Brenda realizoheshin shumë aktivitete. Ai kishte bërë shumë për dekorimin e atij pallati, më shumë se çdo paraardhës. Në një nga sallat kryesore, Petraqi vuri re parinë e shkollës dhe nxitoi që t'i jepte dorën me radhë të gjithëve. Me një përulje që i ka hije një fisniku, filloi t'u puthte dorën zonjave me radhë. Pasi mbaroi urimet e parisë, në pjesën fundore të sallës ai pa Mirkon në shoqërinë e pjesës më të madhe të grupit të gjermanishtes, të cilët e ftuan me shumë dashamirësi që të qëndronte pranë tyre. Në krah të Mirkos qëndronte një mik, i quajtur Robert Muzil. Sikurse do të merrte vesh më vonë, ai do të bëhej një nga shkrimtarët dhe filozofët më të njohur në Vjenë. Ai ishte një mesoburrë me mustaqe dhe me një ballë të lartë. Nga mënyra se si qëndronte, dukej sikur kishte lindur me frak. Më pas do të bëhej shumë i famshëm me novelën e pambaruar "Njeriu pa cilësi". Personazhi i tij kryesor, Ulrihu, njeriu pa cilësi, pasi dëgjoi për herë të parë të flitej për një kalë gjenial vrapimi, hoqi dorë tërësisht nga ambiciet e tij... Në atë kohë, në vitin 1913, ai ishte një shkencëtar që premtonte dhe ndiente që nuk ka asnjë rëndësi që të përpiqesh! Në rininë e tij prej kazerme, Ulrihu nuk kishte dëgjuar për asgjë tjetër veçse për gra dhe për kuaj, dhe u ishte shmangur të gjithë këtyre për t'u bërë njeri i madh, por pikërisht në çastin kur pas

përpjekjesh të shumta, dhe kur ndoshta do të kishte ndier se i ishte afruar qëllimit të aspiratave të tij, një kalë na kishte dalë shumë më i zoti dhe e kishte lënë prapa.

Nga ata të dy, Vasoja kishte shfaqur gjithmonë interes për letërsinë. Menjëherë kishte filluar bisedën me shkrimtarin simpatik. Pas një prezantimi të shkurtër ai i kishte entuziazmuar duke u thënë se edhe ai kishte mbaruar studimet për inxhinieri. Më pas kishte studiuar për letërsi dhe filozofi. Kur mori vesh pasionin e Vasos për letërsinë dhe faktin që studionte mjekësi, me shumë dashamirësi i kishte përsëritur thënien e Konfucit: "Çdo njeri duhet të punojë atje ku ka pasionin, që të ndiejë që nuk ka punuar asnjë ditë". Nuk kishte shumë që kishte publikuar librin me tregime të shkurtra "Three Woman". Me shumë modesti kishte rrëfyer se kishte takuar në Pragë shkrimtarin e mirënjohur Franc Kafka. Ai shprehte një admirim të hapur për Niçen, Dostojevskin dhe Ernest Mahun. Me gjermanishten e çalë, Vasoja e kishte shumë të vështirë t'i jepte të kuptonte shkrimtarit që kishte përballë, se ishte privilegj i veçantë për një student modest si ai, të shkëmbente opinione me të. Pas shpatullave të tij Petraqi po kërcente me Martën, bashkëshorten e shkrimtarit, nën tingujt e një valsi të Shtrausit. Të gjithë vallëzonin. Në qoftë se do të shikoje nga lart prej lozhave të sallës, dukej sikur të gjithë bashkë duke vallëzuar përbënin një kërcim të vetëm, në një trup të vetëm dhe në një ritëm të vetëm.

"Këtë veçanti e ka vetëm valsi", fantazonte me vete Petraqi. Me modesti mendonte që do të ishte ai që do të

promovonte në vendin e tij disqet e valseve pa mbarim të Shtrausit. Asnjë pengesë nuk do ta ndalte në importimin e kësaj kulture sublime. Nuk shqetësohej pak sa herë që i takonte të dëgjonte këngë pa fund me motive orientale, të cilat, me gjithë vlerën që kishin, i ishin imponuar tej mase folklorit vendas dhe e kishin deformuar së tepërmi. Kjo e bënte, në shumë raste, edhe ksenoman. Të paktën, nëse do të influencoheshin, ia vlente me një art të epërm. Sa herë që ngrinte kokën lart dhe shikonte elementet dekorative dhe shandanët pa fund të Pallatit të Habsburgëve, mendonte se një art i madh, pa dyshim, kërkonte edhe një realitet të madh. Vjena për kohën ishte qendra europiane e modelit muzikor, për shkak të madhështisë së klasicizmit muzikor që kishte krijuar. Në këto mendime iu desh të ulej dhe të trokiste nga një gotë me shampanjë me miqtë e kursit të Vasos. Ata qëndronin në anën tjetër të sallës. Prezantimi ishte i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë. Përballë kishte dy djem të çiltër vjenezë, të cilët, në vendin e origjinës së tij do t'i kishin marrë për vajza. Ata ishin në shoqërinë e dy femrave, që nuk dilnin nga modeli i nimfave të mermerta, që ai kishte parë sapo kishte shkelur në stacionin e trenit në Vjenë. Njëra vinte më e tendosur. Ajo kishte flokë gështenjë që i vareshin mbi supe. Sa herë që lëvizte qafën e mermertë, dukej sikur flokët vallëzonin Shtrausin më mirë se ata që përpiqeshin me pasion. Nuk pati nevojë që ta prezantonte kush. Sapo u panë në sy, ajo iu drejtua Petraqit, duke i thënë se emri i saj ishte Sofia. Ishte në një fakultet me

Vason. Ajo kishte dëshirë të vallëzonte me Petraqin, nëse kjo përbënte kënaqësi edhe për të.

Si çdo i ri, edhe ai ndiente neveri për klasiken. Të rinjtë kanë të drejtë që e adhurojnë modernizmin, sepse nuk duan të lodhen shumë. Në vendin e tij, historia nuk e kishte lënë të hynte në shekullin modern. Do t'i duhej që të linte një pjesë të mirë të jetës për të bindur një hirushe, duke i thënë pa reshtur që e dashuronte marrëzisht. Ajo, pasi të sigurohej, së pari ekonomikisht, por edhe moralisht, fillonte t'i jepej dalëngadalë, saqë edhe një jetë e tërë nuk do t'i mjaftonte për të shuar epshin. Ishte hera e parë që atë e kërkonte një damë për të vallëzuar me kaq siguri dhe pa drojë, duke e parë në pishë të syrit. Kur e preku në trup, u sigurua mirë se energjia që mori nuk përputhej me pamjen e mermertë. Ky lloj mermeri kishte shumë energji, e cila po i bllokonte edhe këmbët. Dalëngadalë nuk po ndiqte dot ritmin e vallëzimit vals. Këmbët po humbitnin gjallërinë. Ishte pikërisht dama ajo që po e drejtonte të tërin në këtë vallëzim, duke e sjellë dhe rrotulluar si një gogël që e përdredhim në duar. Ai po ndalej tërësisht. E vetmja gjë që dëshironte në atë çast, ishte të vendoste kokën në mes të atij gjoksi të ngjeshur, që lëshonte një aromë dehëse dhe të mos mendonte për asgjë tjetër. Ajo që e nxori nga kjo gjendje ishte vetë Sofia. E pyeti se si ndihej në Vjenë, pasi kishte kaluar një kohë relativisht të konsiderueshme. A kishte mundur ndopak të kishte përmirësim me gjuhën? Petraqi, me një buzëqeshje që i buronte nga bota e patjetërsueshme e instinkteve, i tha se

tashmë ndihej si në shtëpi. Gjuha i mjaftonte tërësisht për të shprehur ato ndjenja që ishin më të rëndësishmet në jetë. E vetmja që mund të sillte përmirësimin e duhur, do të ishte shoqëria me një nimfë të tillë për të mos pushuar kurrë së foluri dhe menduari gjermanisht. Pas kësaj, ajo pothuaj iu shtri në krahë duke qeshur. Me sy të shndritshëm si të një ujkonje i tha që kjo ishte një kënaqësi tepër e veçantë. Do të ishte gjëja më e vogël që mund të bënte për të.

Gotat e shampanjës vinin pa fund në atë mbrëmje. Petraqi kishte ndier plotësisht që ajo që e kishte dehur, ishte nimfa e mermertë, energjinë e së cilës e kishte ende në trup, megjithëse vallëzimi kishte mbaruar. Nga krahu tjetër i sallës, Vasoja i bëri me shenjë që duhet të largoheshin. Nuk donte të dilte nga ajo sallë që i kishte falur aq shumë gëzim, por Vasoja e kishte marrë vendimin. Pasi ecën në krahë të njëri-tjetrit në një mori korridoresh pa mbarim, sapo dolën jashtë vunë re se hapësira që i panë sytë dukej sikur dikush kishte ndezur një dritë të stërmadhe, apo sikur një kometë kishte rënë aty pranë, duke sjellë një dritë vezulluese, që e kishte bërë edhe më shumë madhështor Habsburgun e pakrahasueshëm. Kishte rënë dëborë. Nata kishte ndryshuar komplet ngjyrat. Sikur të ishte dikush që nuk vinte nga një qytet i ftohtë, nuk do të ishte futur atë natë në shtëpi nga kënaqësia e veçantë e atij qilimi të bardhë, të mrekullueshëm, që kishte mbuluar gjithçka.

* * *

Nuk mund të ketë pranverë më të bukur dhe më të veçantë në botë sesa në Vjenë. Në fund të rënies së Perandorisë Austro-Hungareze, jo më kot ishte qyteti më i madh gjermanishtfolës, me më shumë se dy milionë banorë. Askund nuk mund të gjeje kaq shumë ngjyra lulesh që, të mbledhura bashkë, krijonin imazhin e një parajse hyjnore, në të cilën njeriu shëtit dhe duket më shumë sikur është në qiell sesa në tokë. Edhe për indiferentin më të madh që mund të imagjinojë mendja njerëzore, do të ishte e pamundur të kalonte pa vënë re ndërtesat e pafundme, të kombinuara me stil barok dhe neoklasik. Parqet dhe muzetë e famshëm gjallonin me aristokratë dhe njerëz të shumtë të interesuar, për kulturën e veçantë të këtij qyteti. Muzetë ishin pothuaj të gjithë në stilin e Rilindjes. Në asnjë vend tjetër nuk kishte kaq shumë muze. Aty jepej si një kronikë e gjallë historia e vërtetë e këtij vendi. Në programin e studimit për të huajt, kishte edhe një vend të veçantë për njohjen me kulturën dhe historinë e vendit. Vizitat e dy studentëve shqiptarë nuk kishin të mbaruar me njohjen e muzeve. Gjithsesi, këtë ditë të ngrohtë pranvere, Petraqi bashkë me Vason nuk kishin dalë vetëm për të marrë kulturë, por për të shkëmbyer kulturë. Natyrisht që multikulturat janë gjithmonë të bukura. Ato janë një nga kënaqësitë më të mëdha të jetës.

Rrugës për në shtëpinë e Mirkos, Petraqi po mendonte se, përveç çajit të ngrohtë për të respektuar ftesën, atij

do t'i duhej të përballej edhe me kusuret e ftohtësisë që lënë shpesh politikat respektive në qafën e qytetarëve të thjeshtë. Po mbushej rreth një vit shkollor. Përmirësimet në gjuhë ishin pozitive. Studimi kishte bërë të tijën, por edhe bashkëjetesa e përditshme vjeneze kishte bërë të sajën. Në fund të fundit, gjuha nuk është vetëm një nocion abstrakt teorik, por ka edhe një përmbajtje praktike konkrete, arsye kjo që i kishte shtyrë studentët të tregoheshin më stoikë në të mësuar. "Gjuha nuk të duhet vetëm për të mësuar, por edhe për të dashuruar", i kishte thënë shpesh Rosalina, sa herë që ktheheshin në bujtinën e tyre.

Shtëpia e Mirkos ishte shumë pranë me kishën e Shën Stefanit. Nga dritaret e saj shikoje shumë qartë katedralen, që ngrihej si një gjilpërë gotike rreth së cilës ishte ndërtuar Vjena. Ajo përbënte krenarinë dhe simbolizonte lirinë e qytetit. Kolonat që mbajnë këtë ndërtesë tregojnë historinë. Ato janë të mbipopulluara me statuja shenjtorësh, që duken sikur bëjnë paradë. Kolonat dominuese të çojnë drejt altarit dhe po të ecësh, gjithmonë shkon drejt në statujën Madona de Mantel. Njerëz të të gjitha sferave kërkojnë të gjejnë mbrojtje në mantelin e saj. Nga ana tjetër, Shën Sebastiani martir dhe besnik qëndron fare pranë Madonës. Kleri gotik i gdhendur në gur ranor më shumë se kudo tjetër këtu është një kryevepër. Simbolika e tij është ungjilli. Apartamenti i Mirkos ishte madhështor dhe i dekoruar i tëri në stil të Mesjetës. Sapo futeshe, ndihej aroma e këndshme e çajit. Mushkëritë të mbusheshin me avujt e lehtë të tij. Aty i qerasën me sakertortë me çokollatë

të mbushur me kajsi, një recetë e thjeshtë, por mjaft e shijshme. Një nga ëmbëlsirat më të dashura për vjenezët. Me një vështrim të thjeshtë ndieje se aty jeta studentore ishte arratisur për të mos u kthyer më kurrë. Vërtet ai që jetonte aty kishte kërcyer mbi luksin, por atë kënaqësinë që të jep jeta studentore nuk kishte për ta provuar kurrë. Nuk ishte një ftesë e thjeshtë çaji, sikurse kishin menduar para se të niseshin. Në hyrje të apartamentit, aty ku ai fillonte të zgjerohej si një sallë balloje, ata vunë re Bernardin, plakun mjekërbardhë, me vullnet Sizifi, i cili nuk ndiente të lodhur me leksionet praktike. Ai udhëhiqte grupin në mësimin e pafund të gjuhës. Ishte personi i parë që takuan. Ndodhej në shoqërinë e motrës së madhe të Mirkos dhe të dy pedagogëve të tjerë të jurisprudencës, me të cilët Petraqi shihej sa herë që kishin për të tërhequr bursën e studimit. Më pas, atje ku salla fundohej dhe formohej një kënd me hark shumë të madh kolltukësh, nga ku katedralja dukej sikur mund të prekej me dorë, qëndronin ulur një grup të rinjsh. Petraqit iu desh të rrokej në përqafim, sikur të ishte kthyer nga lufta, me Sofinë. Ajo e ndezi të tërin duke e prekur me duar e duke i folur për kohën e gjatë që nuk ishin parë. Pas shpatullave të Sofisë ai ndjeu lirshmërinë e harmonisë në piano të një vajze brune e të hajthme, që luante Shtrausin. Atë po e ndiqnin të gjithë. Pianoja ishte vendosur në kënd të kësaj salle balloje. Në kokë të protagonistes qëndronin disa djem, të cilët enkas ishin veshur me kostume balloje. Vajza që luante, quhej Emili. Rasti solli që atë ta prezantonte Sofia. Ishte shoqja

e fëmijërisë së saj. Ishte studente në Akademinë e Arteve dhe studionte për piano.

Nga ata të dy, Vasoja ishte gjithmonë ai që tregonte më shumë interes për kampin e kulturës dhe, madje, iu bashkua atyre që i qëndronin në kokë pianistes, nga ku shihej se virtuoziteti tërhiqte më shumë vëmendjen se çdo veprim tjetër. Petraqi ndodhej nën shoqërinë e Mirkos, Sofisë dhe dy profesorëve të universitetit. Në shenjë mirëseardhjeje, Mirkoja u tha se miqtë shqiptarë ishin më të veçantë në këtë mbrëmje. Ata ishin fqinjë dhe i lidhnin historikisht shumë zakone e tradita të përbashkëta, por edhe kontradikta e luftëra, që në shumë raste e kishin vënë fqinjësinë nën thundrën e armiqësisë dhe të urrejtjes. Mirkoja ishte i pjekur politikisht për moshën. Duke parë Petraqin në sy, ai iu drejtua profesorëve vjenezë duke u shpjeguar se Shqipëria kishte hyrë në një rrugë pa kthim sigurie. Reformat për fuqizimin e shtetit demokratik kishin zënë rrënjë. Shteti i Habsburgëve i kishte ndihmuar shumë në këto reforma, por nuk mbetej mbrapa edhe vendi i tij, i cili kishte qenë aty sa herë që në vend kishte pasur kriza politike. Me krenari shtoi se në momente të vështira kishte dhënë goxha kontribut duke dërguar edhe përkrahje ushtarake me anë të forcave të gjeneralit rus të bardhë, Vrangelit, për të shtypur Revolucionin e Qershorit. Sipas tij, Ahmeti dhe gjithë paria e vendit u ishin mirënjohës për këtë. Gjithsesi, nuk i kishte dalë parashikimi, kishte shtuar Petraqi. Ai përmendi rastin e njohur kur një grup dashakeq i ishte afruar Pashiqit dhe i kishin thënë se Shqipëria

tashmë ishte stabilizuar. Ndërsa ai me cinizëm i kishte thënë që të mos mërziteshin aspak: “Shqipërinë e pavarur do ta prishin vetë shqiptarët”. Mirkoja ndjeu kuptimin e përgjigjes së Petraqit. Ai u përpoq të justifikohej, por bisedën e ndërpreu një nga profesorët duke përmendur Konferencën e Paqes së Parisit të vitit 1919. Ai tha se, sikur projekti për copëtim të mos ishte denoncuar nga amerikanët, Shqipëria do të ishte eliminuar nga harta e një shteti sovran. Antishqiptarizmi ishte i frymëzuar nga kancelaritë europiane, me mbështetjen e Francës dhe të Rusisë, me satelitë Greqinë dhe Serbinë. Ata shtuan se, sipas trashëgimtarit të fronit austro-hungarez, Franc Ferdinadit, në marrëveshje me Italinë, Shqipëria duhej të mbetej një shtet i pavarur për të ruajtur baraspeshën ballkanike dhe për të penguar hegjemoninë e pakufizuar të sllavëve. Pas kësaj ra heshtja. Ajo që e theu ishte Sofia. Duke e tërhequr mënjanë i tha se do të kishte dëshirë të dilnin bashkë. Mund të qëndronin për të pirë diçka së bashku me Emilinë.

Kur dolën, ajri i ngrohtë i pranverës u guduliste fytyrën. Aroma dehëse u futej nga të gjitha organet e fytyrës. Petraqi ndiente gjoksin e Sofisë të ngjeshur pas krahut dhe e tëra e varur pas krahut të tij. Mezi priste të ulej në klub. Aty mund ta puthte pa fund dhe pa drojë. Nga ana tjetër, Vasoja po fliste plot interes me Emilinë, a thua se do ta braktiste përgjithmonë profesionin e mjekut dhe do t’i hynte pianos. Mendonte se ishte vetë muzika që e kishte bërë kaq të bukur Emilinë. Ajo mbante një kapelë

me një lule të bukur në kokë, që harmonizoj në mënyrë të përkryer me trupin e hajthëm. Krahët e hollë elegantë përfundonin në disa gishtërinj të ndjeshëm me damarë, që spikatin. Po t'i vështroje nga afër, dukeshin sikur flisnin dhe të përkëdhelnin të tërin vetëm duke i parë. Flokët i kishte të zinj, që përfundonin mbi supet e holla me një onde të vetme, që dukej si një valë deti, që aq sa të freskon kur hidhesh mbi të, edhe të ledhaton kur ndeshesh. Sytë i kishte ngjyrë kafe dhe shumë të butë. Ata ndizeshin vetëm kur i takonte të luante pjesë të vështira, që paraqisnin momente të rëndësishme, nga ato që muzika përpiqet të reflektojë thellë në përputhje me jetën. Asnjëherë nuk e kishte parë Vason aq të kontraktuar në një bisedë me një vajzë. Nga të tre shokët e fëminisë, ai ishte më i talentuari. Ishte kitara e parë e grupit. Zëri i parë në serenatat e bandës së tyre. Ishte i drejtpërdrejtë. Asnjëherë nuk nguronte të thoshte atë që mendonte. Në shkollë kishte ecur me talentin dhe mundësitë e tij. Zor se gjeje ndonjë djalë në Korçë që t'i avitej për nga inteligjenca dhe talenti. Në Vjenë mbahej nga bursa që kishte fituar dhe ndihmohej nga të ardhurat e pakta të familjes. Vinte nga një familje e thjeshtë zanatçinjsh. I ati me xhaxhain ishin muratorë. Kishin ndrequr pothuaj gjithë çatitë e Korçës me duart e tyre dhe mbanin familjet me këtë zanat të trashëguar.

Pa u futur mirë në klub, Sofia e mbërtheu me të puthura dhe Petraqi iu përgjigj me të njëjtin pasion. Që pas takimit të parë në mbrëmjen e Krishtlindjeve, ishin takuar edhe shumë herë të tjera. E tërhiqte përherë e më shumë fizikisht.

Sa herë që ndahej me të, vendoste që të largohej, por jo më kot Niçe thoshte: “Trupi ka më shumë të drejtë se dituria më e madhe”. Ajo e kërkonte kudo. Ishte kthyer si një vegël mekanike, që i përgjigjej me korrektesë sinjaleve të saj. I pëlqente tej mase mungesa e ndrojtjes së kësaj vajze. Ndihej i joshur nga pasioni i saj fizik. Puthja e saj ishte e gjatë dhe pa drojë, dhe pasohej nga një përleshje fizike, që e shkundte të tërin. I hiqte të gjitha toksinat e trupit. E bënte të ndihej i gjallë dhe i freskët, sikur ngrihej nga një gjumë i rëndë. Sa herë që ndahej prej saj, nuk kishte rast që të mos i fanitej Pavlina. Ishte bërë si një fantazmë, që e ndiente sikur e kishte pranë sa herë që takohej me Sofinë. Puthja e Pavlinës vinte e ndrojtur dhe e shkurtër, por ndjeshmëria ishte e një lloji tjetër. Nga ato që të venë në lëvizje të gjithë venat e trupit dhe të mbërthejnë si një rrymë elektrike. Edhe këtë natë, pas ndarjes me Sofinë, i dukej sikur kishte pranë hijen e Pavlinës. Me gjithë joshjen e ëmbël të Sofisë, mezi priste sapo të ndahej, që të lexonte letrën e saj. Ishte letra e tretë që kishte marrë, pas asaj të Krishtlindjeve. Pavlina i përshkruante me detaje pothuajse gjithçka ndodhte në qytet. Me një stil të hollë romantik i shpjegonte se sa shumë i mungonte. Mezi priste që ta shihte atë behar. Emocionet që i jepnin këto letra, ishin shumë më të forta sesa ato të librave të Gollsuorthit dhe të Turgenievit që kishte lexuar në adoleshencë. Malli e përpinte të tërin. I dukej sikur ndjenja dhe dashuria e vërtetë ekzistonin vetëm në një vend në botë, në vendin ku kishte lindur ai. Kockë e lëkurë bëhej. Malli e përpinte

të tërin, megjithëse në Vjenë nuk i mungonte asgjë. As vetë nuk e kuptonte ku e kishte gjetur atë ndjenjë të thellë përgjegjësie për vendin nga vinte. Ky dreq patriotizmi, pa dyshim që lind. Përndryshe s'ka se si t'i dukej sikur Shqipërinë ia kishte lënë dikush nën përgjegjësi. Për çdo gjë që aty mund të shkonte keq, përgjegjësia ishte e tij! Pjesë të trupit po ta kishte, nuk do t'i dhembte kurrë aq shumë sa kur dëgjonte një fjalë të rëndë për të. Ndoshta as syri nuk ishte, as truri, por shpirti vetë, i cili, kur sëmuret është ai që dhemb më shumë. Aq shumë mendonte për atë vend, saqë në muajt e parë nuk kishte natë që mos ta shikonte në ëndërr. Zgjohej herët në mëngjes, kur shihte ëndrra të tilla dhe nuk mund të vinte gjumë në sy. Nuk ishte i pasur në Shqipëri, por çdo centimetër tokë e saj i dukej sikur ishte e tij. Për të qenë i saktë, vetëm aty i dukeshin të vërteta gjërat. Dashuria kishte tjetër shije, pasuria kishte tjetër vlerë, koha kishte tjetër kuptim, kurse miqësia nuk kishte çmim.

Kur Vaso u kthye në shtëpi, dukej shumë më serioz se zakonisht. U përpoq që të shkonte në shtrat pa u përshëndetur dhe pa bërë bilancin e ditës, siç kishin vendosur që kur kishin shkelur në Vjenë. Nuk mund ta quante dashuri me shikim të parë. Vaso, në ndryshim nga të gjithë shokët, ishte i përmbajtur dhe i matur. Ata me shaka e thërrisnin "murgu". Por atë natë Vasoja erdhi shumë i trishtuar. Nuk pranoi të fliste, me pretendimin se ishte i lodhur. Ajo që i duhej në atë çast, ishte vetëm një sy gjumë. Do të kishin kohë plot për të folur dhe treguar

gjithçka njëri-tjetrit. Nata ishte e vështirë për Vason. Ai u përpëlit nëpër shtrat dhe u ngrit disa herë për të marrë ajër në dritare. Kur po hanin mëngjes, ishte pa fjalë dhe i mbyllur. Trishtimi i thellë që e kishte përpirë, i dha të kuptonte Petraqit që mund të kishte rënë në dashuri. Nga të mos binte në dashuri, mendoi, duke përfytyruar Emilinë. Edhe vetë mitropoliti i Shën Gjergjit po ta kishte parë, do ta kishte lënë rrugën e Zotit për të.

Ditën e takimit në ambasadën shqiptare në Vjenë ambasadori Milto Korinthi nuk ishte treguar aspak i kursyer në ftesa. Ambasada ishte mbushur më shumë sesa në festën e ditës së pavarësisë. "Ka të drejtë", mendoi me vete Petraqi. "Këtë radhë ka ardhur vetë Naltmadhnia." Gjallëria ndihej kudo. Kurrë nuk kishte menduar që kaq shumë shqiptarë mund të jetonin në Austri. Edhe në Tiranë po të bëhej kjo ceremoni, nuk do të mblidheshin kaq shumë njerëz. Kishin ardhur nga të gjitha viset. Disa prej tyre mbanin veshur kostume popullore, për të cilat të huajt thoshin se ishin kostume të papërsëritshme dhe unike. Ambasada shqiptare ndodhej në qendrën historike të Vjenës, e cila dominohet nga Ringstrasse. Në vitin 1860, Perandori Jozef e zëvendësoi pjesën mesjetare me këtë bulevard mbresëlënës, që vinte prej bërthamës së qytetit. Ringstrasse është një nga rrugët më të mëdha të Europës. Ajo është e veshur me arkitekturë të veçantë dhe nëpër të lëvizin tramvaje që e qarkojnë nga brenda gjithë qytetin. Ambasada ishte godina më e spikatur e kësaj rruge. Ajo ishte e ndërtuar me një stil madhështor mesjetar. Kishte

plotësisht hijen e një pallati të një fisniku të rënë nga vakti. Në hyrje të ambasadës, diku pranë portës kryesore, Petraqi bashkë me Vason, i shtrënguan dorën ambasadorit. Ai kishte në krah bashkëshorten. Pas saj ishte rreshtuar në krah i gjithë stafi. Aty ku grumbulli i njerëzve ishte pothuajse i padepërtueshëm, përbri oxhakut madhështor të sallës kryesore, i veshur me një kostum të rëndë, me qostek, shkëlqente vetë ai, prijësi hijerëndë i shqiptarëve. Ishte rrethuar nga një turmë burrash, ku ishte e pamundur të gjeje ndonjë pa mustaqe. Vetëm ai fliste. Të gjithë e dëgjonin me vëmendje dhe miratonin me kokë. Ndërkohë, karvanë të tërë njerëzish me përulësi hiqeshin zvarrë për t'i puthur dorën dhe për t'i uruar mirëseardhjen. Këtij karvani iu bashkuan edhe ata të dy. Kur i shtrënguan dorën dhe iu afruan, vunë re më mirë se ai kishte një hije shumë të rëndë, të cilën e shtonte edhe më shumë, me qëndrimin e tij, dhe me pamjen prej kreshniku. Po ta vështroje përciptazi, ai kishte pamjen e një oficeri austriak për shkak të qëndrimit prej më se dy vjetësh në Vjenë. Nga balli i dilte një hundë shqiponje dhe aspak e harkuar, që tregonte më së miri se prijësi nuk ishte aspak tolerant. Në të dyja anët e hundës së fortë dhe të mprehtë spikatnin dy sy, të cilët vetë krijuesi i kishte kompozuar, sa dinakë dhe burrërorë, të cilët prijësi i kombinonte më mirë se vetë krijuesi. Kafka dukej sikur ishte prej çeliku dhe të krijonte bindjen, që në pamjen e parë, se këtë lloj njeriu nuk mund ta bindje dot kurrë vetëm me forcën e arsyes. Ajo mbështetej në një zverk stoik, që buronte nga shpatulla burrërore, të cilat më

shumë dukeshin si të një sharrëxhiu sesa të një politikani aq të hollë dhe të rafinuar sikurse ishte në jetën reale Naltmadhnia. Trupi i skalitur mbështetej në dy shtylla të hekurta, që qeniet humane i quajnë këmbë, që përfundonin në dy shputa të gjera dhe të mëdha si të ariut. Dukeshin sikur ishin zbathur, megjithëse ishin futur në këpucë me lëkurë luksoze. Si mund të qëndronte beqar një njeri i tillë, i cili dukej si një dem hamshor i racës ariane dhe të jepte përshtypjen që mund t'i merrte frymën një haremi të tërë?! Pas shpatullave të Petraqit qëndronin dy zonja të vërteta. Ato dukeshin njëherazi që nuk ishin nga vendlindja e të zotëve të shtëpisë. Me instinktin e djelmoshave, Petraqi me Vason i përshëndetën në gjermanisht duke i ftuar që të pinin nga një gotë shampanjë. Nga prezantimi mësuan se njëra nga zonjushat vjeneze quhej Franceska Branko. Ndodhej aty së bashku me motrën e saj si e ftuar personalisht nga prijësi i shqiptarëve. Ato vinin shtatlarta, shumë të hijshme, të bëshme dhe të kuruara. Njëra prej tyre, ajo që në prezantimin e parë hiqej sikur nuk i interesonte shumë miqësia me djelmoshat, vinte edhe më e plotë e me një trup kodra-kodra. "Kushedi si duket e zhveshur", mendoi me vete Petraqi. Me mirësjellje po përpiqej shumë që t'i tërhiqte vëmendjen, duke menduar, nga ana tjetër, se edhe Vasoja mund të dilte nga mërzia që e kishte pushtuar duke u argëtuar me motrën e Françeskës. Me dy gota shampanjë në dorë ai iu afrua edhe një herë zonjushave. Ato filluan të buzëqeshnin dhe të shfaqin interes. Françeska i tha se e njihte Shqipërinë. Kishte qenë

për ca kohë atje, por nuk kishte mundur dot të mësonte ndonjë gjë për jetën dhe zakonet. Megjithëse ky prezantim për Petraqin ishte i çuditshëm, ajo që e tërhiqte te këto dy zonjusha, ishte fiziku. Sikur të mundte t'i tërhiqte edhe më shumë vëmendjen, do të ishte i gatshëm të ikte menjëherë nga pritja e mrekullueshme në ambasadë dhe të ndeshej ballazi e pafundësisht me këtë zonjushë, derisa t'ia kërciste kockat nën afshin e një epshi të shfrenuar. Nuk arriti të fantazonte më shumë. Pas shpatullave ndjeu dorën e sekretarit të ambasadës, i cili e tërhoqi mënjanë. Ai i tha që duhej të largohej sa më parë nga zonjushat, pa i dhënë ndonjë arsye.

Kur u kthye, pa që vetë ambasadori, zoti Korinthi, i shtriu dorën Françeskës, duke e ftuar që t'i bashkohej Naltmadhnisë. Me një gjermanishte të zhdërvjellët, ai i prezantoi zonjushat me një politikan të sërës. Françeska, në krah të prijësit nuk kishte asnjë lloj kombinimi. Gjithsesi, Naltmadhnia vinte nga ata burra që, kur lakminë nuk e përmbushin dot me arsye dhe elegancë, nuk e kishte problem të përdornin forcën dhe paranë. Ajo që thoshte me të drejtë Fukoi se "aty ku flet e pavetëdijshmja, njeriu nuk ekziston", nuk përbënte asnjë rëndësi për të. Bashkë me Vason ata iu bashkuan një grupi shqiptarësh që këndonin këngë arbëreshe dhe kujtuan me nostalgji të shkuarën e bukur. Në dalje takuan përsëri sekretarin e ambasadës. Ai ishte mik i babait të Petraqit. Duke i shtrënguar dorën, me një buzëqeshje ironike në fytyrë, i pëshpëriti në vesh fjalën e urtë të vatanit se duhet të bënte më shumë kujdes, pasi

“qeni të ha për buçen”. Pak vite më pas, kur po mbaronte studimet, mundi të vërtetonte kuptimin e kësaj fjale dhe se cila ishte në të vërtetë ajo vajzë e mbushur me hire e quajtur Françeska. Një nga gazetat më të përmendura publikonte në faqen e parë atentatin që iu bë Naltmadhnisë nga dy bashkëkombës, në çastin që po dilte nga opera në Vjenë i shoqëruar nga dy rojat e tij. Pasi kishte shpëtuar paq, ishte drejtuar për në hotel “Imperial”, ku e priste Françeska. Një zot e di a kishte mundur ta mposhte dot mërzitjen nga humbja e miqve nën krahët e mikes së preferuar, për të cilën e thoshte hapur ngado se i sillte vetëm qetësi dhe fat.

Nuk besoj se mund të kishte ndonjë njeri në Vjenë që ta priste me aq shumë qejf ardhjen e së dielës sesa Vaso. E diela ishte e vetmja ditë kur studentët mund t’i kushtoheshin vetes dhe të shpëtonin nga kthetrat e studimit, të cilat në shkollat gjermanike janë më të gjata se kudo tjetër. Gjithsesi, ajo që e bënte të veçantë për Vason nuk kishte të bënte me këtë. Çdo të diel në mëngjes, në shoqërinë e së ëmës dhe të babait, Emilia vinte në katedralen e Shën Stefanit. Aty ku rrugët kryqëzoheshin dhe ku sheshi përballë katedrales zgjerohej më shumë, ndodhej bari, ku më shumë se në çdo vend tjetër në qytet, kanë shkelur të dashuruarit. Vaso vinte i pari në bar, kur ende nuk ishte hapur mirë. Nuk kishte pasur ndonjë rast që dikush të mbërrinte më parë në tavolinën e preferuar, atje pranë dritares, prej nga mund të shihte tek dilte Emilia nga katedralja, dhe të merrte drejtimin për tek ai. Megjithëse ishin vetëm pak metra largësi, përherë i ishin dukur si orë të

tëra hapat e saj derisa të mbërrinte tek ai dhe ta përqafonte, sikur do ta takonte për të fundit herë. Kur e kishte të mbërthyer në krahë, përherë ndiente bashkë me të edhe melodinë e pianos. As Zoti nuk mund ta ndante dot Emilinë nga tingulli i pianos. Disa herë, me naivitet kishte mbyllur veshët, por ishte zhgënjyer si një fëmijë. Një zot e di se nga buçiste tingulli! Emilia dhe pianoja ishin një trup, një shpirt, një mendje, një figurë. Edhe kur ecte, ajo formonte melodi. Edhe kur lëvizte krahët, formonte melodi. Edhe kur qeshte, formonte melodi. Po çfarë duhej të thoshte Vasoja kur ajo e përkëdhelte me duart e ndjeshme, që nuk ngopej vetëm duke i parë? Po ku mund ta gjente forcën për të shpjeguar se çfarë ndiente kur putheshin bashkë?! Zoti, për fat të keq, nuk ia kishte dhënë atë forcë, megjithëse ai mendonte se nuk ia kishte dhënë ndokujt mbi tokë?! Nga ana tjetër, një gjë e dinte shumë mirë, se këtë ai e kishte ndier më shumë se kushdo dhe kurdoherë. E për çfarë do t'i duhej që të shpjegonte një gjë të tillë? Kurrë nuk do të merrte mundimin! Edhe sikur poet të kishte lindur, nuk kishte dëshirë ta ndante me askënd këtë kënaqësi. I treti mbërrinte Petraqi. Pasi përshëndetej me çiftin e të dashuruarve, prisnin të katërtin, që ishte gjithmonë Sofia. Rituali ishte i përjavshëm. I njëjti klub, të njëjtët miq, bile edhe e njëjta meny. Strudeli i famshëm i përgatitur me brumë si të bakllavasë, që i kujtonte qytetin e lindjes, vinte përherë i shoqëruar me kafe. Ai ishte me mollë që vinin nga gjermania, i nakatosur me sheqer, kanellë e rrush dhe i spërkatur me salcë limoni. Në klub nuk qëndronin shumë,

sepse i priste shëtitja e gjatë. Të kapur për dore, frymën do ta mbanin në pallatin Shën Brun, në periferi të Vjenës, ku ishte rezidenca verore e familjes së Habsburgëve. Atyre u pëlqente stili i brendshëm barok, i preferuari i monarkëve hyjnorë. Dekori barok shërbente si një propagandë për të përhapur idetë e regjimit, sepse disa kishin lindur për t'u bindur dhe disa të tjerë për të sunduar. Pallati ishte i tëri i mobiluar me stilin e viteve 1800 të perandorit Franc Jozef, mishërim i mbretërisë Habsburge. Ai kishte një edukim të fortë dhe ndjenjë të fuqishme të detyrës. Nga ana tjetër, mbretëresha e bukur Elizabetë, e njohur nga vendasit si "Sisi", kishte si qëllim të fortë që të ruante me çdo kusht bukurinë femërore. "Paska shumë arsye pse janë kaq të bukura Emilia dhe Sofia", thoshin përherë ata sa herë që vizitonin pallatin.

Në vitin 1898, gjatë një vizite në Zvicër, mbretëresha Elizabetë u vra nga një anarkist italian. Ajo ishte shumë e bukur. Jeta e Elizabetës qe e ëmbël, ndërsa vdekja tragjike. Vizita përfundonte në dhomat e thesarit mbretëror, i cili ka bizhuteritë më të mira në Europë. Për të gjithë ata që e shikojnë, do të duhet të reflektojnë mbi shkëlqimin e njëzet dhomave të mbushura me gurë të çmuar, projektuar për të mbajtur thesarin mbretëror. Në koleksion bënte pjesë dhe kurora mbretërore e shenjtë romake. Tetë harqet mbi kurorë përfaqësojnë portat e Jerusalemit. Gurët e çmuar të panelit të përparmë përfaqësojnë të dymbëdhjetë apostujt.

Ngjitur me pallatin gjendet edhe një kishë shumë e rëndësishme e historisë së Habsburgëve, në të cilën Emilia

e kishte ëndërr të bënte dasmën. Kthimi ishte dhe më i bukur. Ata ktheheshin gjithmonë në të njëjtën rrugë duke shëtitur në parqe të mbushura me statuja, duke parë dhe prekur kujtime nga vitet më të lavdishme të Austrisë dhe kulturës së saj të lartë. Ishte vërtet fat i madh për ata që studionin atje në një kohë kur Vjena ishte veshur me filozofinë romantike. Ajo kishte një arkitekturë të shkëlqyer. Ishte bërë prej kohësh nëna e muzikës. Historinë e gjeje kudo, edhe te muzika e rrugëve. Emilia i thoshte përherë se jo shumë kohë më parë vetë Johan Shtraus kishte luajtur muzikë në parqet e kryeqytetit. Shëtitja mbaronte pothuaj aty ku kishte nisur, pranë katedrales, në qoshe të rrugës, ku ishin sanduiçët më të mirë vjenezë. Të shoqëruara me birra, më shumë të hapnin oreksin, thoshte Petraqi, sesa të ngopnin. Pas kësaj dreke të thjeshtë, mbaronte e diela. Të dy miqve u duhej t'i nënshtroheshin ritualit të përhershëm duke përgatitur gjithçka për të nesërmen në shkollë, ku përherë i dukej që po e fillonin nga e para. Pedagogët e universitetit ishin prerje unike. Toleranca ishte pothuaj zero. Të dy studentët e kishin provuar se e vetmja rrugë për të ecur përpara ishte përveshja e mëngëve mirë. Në të kundërt, nuk kishte zot që mund t'i shpëtonte. Dy shkencat e tyre ishin të ndryshme. Asnjëri nuk mund të thoshte se kush e kishte më të vështirë. Një gjë kishin të sigurt, se përveçse t'i jepnin kurajë njëri-tjetrit, s'e ndihmonin dot ndryshe.

* * *

Petraqi e kishte pritur me shumë dëshirë ftesën për të ndjekur leksionin e profesorit me famë, për më tepër që ftesën e kishte marrë nga Sofia. Do të takoheshin bashkë si zakonisht në sheshin para Katedrales së magjishme. Edhe prej druri, edhe pa sy sikur të ishe, aq herë sa e shikoje, aq herë do të holloheshe, jo vetëm shpirtërisht, por edhe fizikisht. Kjo kishte ndodhur me të gjithë këto vite studimi. Ishte bërë më i ndjeshëm dhe më i trishtë. Tashmë nuk ishte një student i ri. Koha kalonte shumë më shpejt në Vjenë. Nga të dyja kategoritë filozofike, hapësirë dhe kohë, ajo që kishte lëvizur ishte vetë koha në Vjenë. Ishte pikërisht ajo që lëvizte shumë më shpejt sesa në vendlindje. Atje, për fat të keq, koha kishte ngelur në vend, për një periudhë të gjatë. Kishte vendosur të qëndronte e ngurtësuar, për të mos thënë që në momente të caktuara, në kundërshtim me ligjet e historisë, kishte ecur mbrapsht. Një zot mund ta dinte se kur do të merrte inercinë e duhur për të lëvizur. Ndërsa hapësira kishte mbetur e njëjtë. Magjepsej me katedralen, megjithëse e shikonte çdo ditë. Nuk kishte pasur qoftë edhe një ditë të vetme që të mos e ngadalësonte hapin, sapo fanitej ajo. Para portës së saj të lartë bënte kryqin. Me mendje ngrinte krahët për ta përqafuar. O Zot, sa mëkatar ndihej kur hynte brenda dhe avitej në altar. Shumë më i përulur dhe mëkatar ndihej kur e gjente të zbrazët, pa njerëz. Ndjenja e fajit e pushtonte të tërin. Mërmëriste nën buzë gjithë ato

premtime, që i kishte bërë vetes dhe që, për dreq, i dilnin shumë. Shumë prej tyre, të pambajtura e të parealizuara. Nuk gjente dot forcën, por edhe sekretin për t'i mbajtur! Me këmbë zvarrë dilte prej andej, sepse asnjëherë nuk kishte pasur besimin se do ta mbante premtimin deri në fund. Asnjëherë nuk ishte ndalur. Këmbadoras hynte në altar. Me kokën ulur betohej se edhe i vdekur po të ishte, frymën do ta mbante vetëm në një vend. Atje ku kishte lindur. Atje ku nuk kishte kisha kaq madhështore, por jetonin në miliona vjet malet më madhështore në botë. I urrente pa masë poetët e modernizmit të fillimshekullit, që stigmatizonin se natyra është nocion universal dhe i njëjtë për të gjithë. Ajo që ndryshon është njeriu! Vetë subjekti që interpreton! Kanë të drejtë të mjerët, sepse nuk kanë parë shumë, mendonte gjithmonë për ta.

Nuk pati mundësi të mendonte më gjatë, sepse Vasoja me Emilinë u shfaqën. A thua se kishin rënë nga qielli. Si gjithmonë, Sofia erdhi e fundit. Rrugën për në sallën e lektorit, që kishte pushtuar gjithë mendjet më të regjura të botës me ato që thoshte për neurozat dhe reaksionet sociale, që krijoheshin nga instinktet e ndrydhura, do ta bënin bashkë. Më i emocionuar ishte vetë Vasoja. Pasioni për mjekësinë e kishte pushtuar të tërin. Çdo shpjegim mbi jetën kishte filluar ta bënte nëpërmjet mjekësisë. Kishte asistuar në shumë trajtime të të sëmurëve mendorë në spitalet më të mira të Vjenës. Nuk do të ishte e largët koha kur edhe ai do të merrte në dorë trajtimin e tyre me metodat e kohës. E kishte zgjedhur këtë specialitet pas

sugjerimit të një profesori të njohur vjenez. E mundonte fakti i thjeshtë se në Korçën e tij zor se gjeje qoftë edhe një të sëmurë mendorë. Ajo që e tërhiqte ishte se profesori i madh i kishte thënë se, në kushtet e modernitetit, do të kishte shumë nevojë për mjekë psikiatër. E ardhmja që po vinte me shpejtësi, do të sillte njëkohësisht edhe shumë ankthe dhe dëshira të parealizuara. Të gjitha bashkë do të bënin që të kishte shumë më tepër të sëmurë mendorë. Koha e akumulimit fillestar të kapitalit po kalonte. Shumë shpejt bota do të futej në krizë të rëndë ekonomike. Ajo që e kërcënonte më shumë botën, ishte se shumë intelektualë po projektonin sisteme politike utopike nën sebepin e përballimit të krizave. Kjo përbënte një papërgjegjshmëri të vërtetë intelektuale. Të gjithë ata që do të besonin, do të bëheshin kavje të laboratorit të madh njerëzor. Viktima të vërteta të politikës së papërgjegjshme. Kostoja e këtyre eksperimenteve me jetën njerëzore, do të ishte e pallogaritshme. Askush nuk do të mbante përgjegjësi për eksperimentin. Ajo që do të ngelej pas, do të ishte çmendina nga ndrydhja e lirisë dhe turmat e njerëzve që do të kërkonin të merrnin mjekim. Këtë thoshte përherë profesori i madh. Ai admironte këmbënguljen e Vasos në një shkencë në të cilën ai nuk kishte asnjë mbështetje morale sado të vogël, përveç vullnetit të hekurt.

Që të katërt ishin ulur në sallën në formë amfiteatri. Prisnin vetëm atë, profesorin që kishte tronditur botën mbarë dhe që ende nuk kishte dalë kush t'i lëkundte ato që thoshte me aq shumë besim dhe forcë në vetvete. Salla

ishte e tëra e mbushur me mjekërbardhë. Të vetmit të rinj që dukeshin haptazi, ishin vetëm ata. Emilia e hoqi e para kapelën e hijshme që mbante në kokë. Të njëjtën gjë bëri me bindje edhe Sofia. Në sallë kishte rënë një heshtje varri. Të gjithë prisnin me padurim të hynte profesori i madh. Një nga ata që po e priste me padurim, ishte Vasoja. Ai ishte një nga studentët më të spikatur të universitetit. Nga pedagogët ai quhej një djalë që e kishte kapërcyer nivelin e studentit. Debatet e tij tejkalonin parashikimet edhe të profesorëve më skrupulozë.

Profesori i madh hyri me një hap të ngadaltë, i ndjekur me përulësi nga disa asistentë, që e shoqëronin si një perëndi. Ende pa marrë fjalën, ai pozoi më gjeste. Qoftë edhe formalisht të jepte të kuptoje që ato që do të thoshte, nuk i kishe dëgjuar ndonjëherë. Të gjithë duhet të bëheshin gati. Do të tronditeshin shumë nga ato që do të dëgjonin. Profesori i madh, Zigmund Frojd, këtë radhë do të fliste mbi elementin qendror, që përshkon teorinë e tij psikanalitike. Ajo konsistonte në postulatin që shumica e sëmundjeve neurotike dhe atyre psikike, e kanë burimin në pavetëdijen e përjetimeve seksuale që në fëmijëri, duke marrë parasysh edhe faktorin e trashëgimisë. Sipas konstatimit të tij, në librin "Hyrje në psikanalizë", ai thoshte se zbulimi i parë, në të cilin na çon psikanaliza, është që të gjitha simptomat e sëmundjes kanë lidhje direkte dhe të drejtpërdrejtë me jetën erotike të të sëmurit. Pra, sipas tij, çrregullimet e jetës seksuale janë shkaqet kryesore të sëmundjes. Në qoftë se dikush kërkon t'i kurojë me sukses këto trauma,

duhet të zbulojë me kujdes ngjarjet e jetës fëmijërore dhe të rikthejë në vetëdije këto kujtime, të cilat zakonisht janë harruar dhe fshirë nga kujtesa. Vetëm në këtë formë mund të kuptojmë sensibilitetin e traumave neurotike, thoshte me pompozitet profesori. Edhe ata kolegë mjekë, ose studiues të ndryshëm që e kundërshtojnë këtë fakt, thoshte ai me pedantizëm, shpjegimi gjendet nën faktin se nën presionin e edukimit kanë harruar shfaqjet erotike të jetës së tyre fëmijërore, ose thjesht nuk duan t'i kujtojnë më ato. Profesori Frojd thoshte në mënyrë të prerë se njerëzit sëmuren kur plotësimi i nevojave të tyre erotike bëhet i pamundur, si pasojë e pengesave të jashtme, ose të papërshtatshmërisë së pamjaftueshme që ekzistojnë midis partnerëve, sepse instinktet seksuale nuk pranojnë të heqin dorë nga kënaqësia. Ai përfundonte se, sipas psikanalizës së tij, në epiqendër ndodhet sistemi nervor, pavetëdija, pra të gjitha këto neuroza varen nga trupi material, argumente që të çojnë në teorinë materialiste. Me përfundimin e leksionit, që megjithëse zgjati shumë, atyre u ishte dukur sikur kishin parë një film me metrazh të shkurtër. Më pas fjalën e kishin marrë profesorët mjekërbardhë, të cilët kishin bërë shumë pyetje. Ai që kishte pyetje të vërtetë ishte Vaso. Ishte gati të pëlciste sepse rregullorja e universitetit nuk lejonte pyetjet e studentëve, në rastet e leksioneve të akademikëve. Nga ajo që kishte dëgjuar kishte arritur të kuptonte se, sipas profesorit Frojd, dëshirat seksuale, ose instinktet seksuale të frenuara, janë të ngjashme me ato të kafshëve të larta, gjitarëve, të cilët, edhe ata, ashtu si

njeriu hanë, pinë, flenë edhe riprodhojnë. Nëse instinktet seksuale janë bazë e aktivitetit të njeriut dhe frenimi i tyre na çon në shfaqjen e sëmundjeve neurotike, atëherë në këtë fushë nuk kemi ndonjë ndryshim cilësor nga kafshët, por kemi një ndryshim sasior, sepse njeriu është i pajisur me një logjikë që kontrollon instinktet. Sipas Vasos, profesori po bënte një ngatërresë parimore. Ai identifikonte instinktet seksuale si shkak të sëmundjeve që janë karakteristike si për kafshët, ashtu edhe për njeriun, me ndjenjat që janë karakteristikë vetëm për njeriun. Kafsha, në marrëdhëniet seksuale nuk udhëhiqet nga ndjenjat, por nga instinktet. Kafshët nuk bëjnë poezi dashurie, as këngë dashurie në kohën e riprodhimit, por kryejnë instinktivisht marrëdhënie seksi, shpeshherë edhe me dhunë të shkallëve të ndryshme. Njeriu ka ndjenja në marrëdhëniet dashurore duke shkruar romane, poezi, kompozime, ku idealizohet dashuria. Ndonjëherë edhe duke kaluar në vetëmohim për dashurinë. Sipas Vasos, nuk ishin instinktet seksuale që shkaktonin sëmundje neurotike dhe psikike sikurse thoshte materialisti Frojd, por prapësimi që i bëhet ndjenjës së dashurisë e cila mund të shkaktojë çrregullime neurotike të shkallëve të ndryshme, që nga neurozat gjer te psikozat e vërteta, gjatë thyerjes apo disfatës në dashuri. Sipas tij, identifikimi i ndjenjave me instinktet, ishte një nga gabimet themelore. Për më tepër që nuk i pëlqente edhe ateizmi i këtij profesori, si dhe një lloj mungese sinqeriteti dhe megalomania, kur deklaronte që nuk e kishte lexuar kurrë më parë Niçen dhe Darvinin, megjithëse teoria e tij

dukej shumë e përfshirë në teoritë e tyre. Të gjitha pyetjeve të profesorëve në këtë leksion, ai iu përgjigj me formulë të njëjtë, duke treguar më së miri se ishte shumë pedant. Kur leksioni mbaroi, Vaso ndihej shumë i nervozuar. Ai do të zhytej sa më thellë në zbulimin e doktrinës së tij, për të qenë sa më i saktë në gjykim. Në fund të fundit, teoria e këtij profesori së shpejti do të përbënte bazën e kurimit të pacientëve me sëmundjet neurotike. Ajo që do t'i interesonte më shumë se kushdo, do të ishte teoria e tij.

Megjithëse ishte një fillim vere në Vjenë, Petraqi për herë të parë nuk e ndjeu romantizmin e saj. Lulet në verë aty janë njësoj si në pranverë. Është i vetmi behar me aromë pranvere fillim e krye. Ky ishte viti më i trishtë, sepse do t'i duhej të merrte shumë vendime të rëndësishme për jetën. Ishte viti i fundit i studimeve. Pa asnjë dilemë dhe pa asnjë mëdyshje vendimin e kishte marrë. Do të kthehej aty ku kishte dhënë fjalën, ku e sillte dëshira dhe pasioni për të kontribuar. Aty ku kishte nevojë më shumë se kudo tjetër. Vetëm një vit më parë kishte qenë në vendlindje. Mezi priste që të përballej me profesionin që kishte zgjedhur. Kishte shumë mendime se si do ta organizonte punën e tij. Ishte i dashuruar me profesionin e avokatit. Për avokatë kishte shumë nevojë, sepse me atë zhvillim që kishte marrë tregtia në Shqipëri, nuk mund të plotësoheshin nevojat, edhe sikur universiteti i Vjenës të punonte vetëm për Shqipërinë. Vetë babai i Sofisë, një nga avokatët më të njohur në Vjenë, i ishte ofruar që ta mbante në studio si partner. Aty do të kishte të ardhura shumë të

kënaqshme dhe një jetë të siguruar. Ky propozim ishte ideuar nga vetë Sofia. Ajo tashmë i kishte thënë hapur se nuk i përballonte dot ndarjet. Por dilema kishte marrë fund një herë e përgjithmonë aty ku kishte filluar, në kishën e Shën Gjergjit, në takimin e fundit me Pavlinën, së cilës i kishte premtuar se shumë shpejt do ta sillte në altar. Sofinë dhe Vjenën do ta ruante si një ëndërr të bukur, të cilën do ta mbante gjithë jetën. Do ta kishte si një sfidë, shëmbëllimin e së cilës do ta kishte njësoj si idetë e Platonit, të cilat, në botën reale ku ai do të shkonte, nuk do të ishin gjë tjetër veçse kopje të zbehta të kësaj bote ëndërrore.

Vasoja e kishte shumë të vështirë. Profesori që e kishte afruar, tashmë e kishte bërë propozimin për ta mbajtur si asistent të tij në lëndën e psikanalizës. Propozimi ishte miratuar. Karrierën e kishte të hapur në Vjenë. S'kishte çfarë të kërkonte më shumë. Nuk do t'i duhej edhe shumë kohë. Atëherë mund t'i drejtonte çfarë pyetjeje të dëshironte profesorit Frojd në leksionet e tij. Sfidën do ta kishte përpara. Emilia sapo kishte dhënë koncertin e fundit. Ishte kandidaturë e parë për në filarmoninë e Vjenës. Ishte më se e lumtur. Nuk kishte kërkuar më shumë. Kishte filluar të studionte pianon që pa u ngritur mirë në këmbë dhe nuk e kuptonte jetën pa të. Gjithçka funksiononte në mënyrë të shkëlqyer. Instinkti e kishte mësuar se, kur gjërat shkojnë shumë mirë, ekuilibri vendoset me diçka që nuk funksionon mirë. Në bisedën që kishin pasur bashkërisht, kishin rënë dakord që për Vason ekzistonin arsye të mëdha për të qëndruar në Vjenë.

Ndërsa për Emilinë, në Shqipëri nuk kishte hapësirë. Për më tepër që prindërit e saj nuk mund të ishin kurrë dakord që ajo të shkonte në atë humbëtirë. Emilia ishte vajzë e vetme. Për familjen, refuzimi për të jetuar me familjet e dokeve i ishte bërë i qartë me kohë. Nga ana tjetër, karriera në fushën akademike do të avanconte shumë shpejt në Vjenë. Të ardhurat do të ishin më të mira se në Shqipëri. Ai do të ishte asistenti i profesorit të psikiatrisë më në zë në universitet. Emilia ishte pianistja më e kërkuar. Çiftit i mbetej për të menduar për të ardhmen, sepse për të tjerat kishte menduar Zoti që i kishte puqur bashkë. Megjithëse ndodhej në këtë situatë, Vasoja nuk e kishte menduar kurrë sa i sinqertë kishte qenë ai betim që kishin bërë atë natë në stacionin e Romës, kur ishin ndarë me Odisenë. Instinkti i vendlindjes e kishte mposhtur arsyen dhe kishte triumfuar mbi gjithçka. Edhe sikur të gjitha po t'i humbte, ai do të kthehej aty ku kishte lindur. Aty ku ndihma që do të jepte, do të ishte shumë më e vyer, përpara qetësisë që i garantonte Vjena. Ajo që ishte në provë ishte dashuria e Emilisë.

Dita e nisjes për në Shqipëri ishte dita e dëshpërimit të madh. Në gjoks mbante një gjendje të dyfishtë, midis dëshpërimit që po largohej nga një dashuri e madhe, për të shkuar në një dashuri edhe më të madhe, dhe të pafund. Petraqi, edhe kur ecte nëpër rrugë, prekte me duar muret e qytetit. Malli e kishte marrë ende pa u larguar. Ceremonia e diplomimit kishte përfunduar. Nuk e kishte menduar asnjëherë se sa shumë i kishte dashur të gjithë

ata, me të cilët jeta e kishte bashkuar në këtë maratonë studimore. Nuk kishte mundur as të shijonte ceremoninë, sepse gjatë gjithë kohës, në takimet që bënte, shkëmbente adresat me shoqërinë e kursit. Nuk kishte mbetur asnjë pedagog, me të cilin të mos ishte ndarë. Mirënjohjes për të gjithë ata që i kishin dhënë dituri, ai do t'i kërkonte vetëm pak kohë, që të provonte se kush ishte. Në fjalën e mbylljes dhe të falënderimit, Petraqi kishte shprehur me fjalë zemre mirënjohjen për mundësinë që i ishte dhënë për të marrë kulturë në Vjenë. Ai falënderoi një për një të gjithë pedagogët që ndodheshin në sallë dhe i krahasoi dituritë që kishte marrë prej tyre me lumin e Danubit, në të cilin bashkohen shumë lumenj të tjerë, dhe që të gjithë së bashku e bëjnë atë aq madhështor. Në fund të sallës e priste Mirkoja me Brankon, dy të pandarët e kursit. Ata e rrokën në qafë alla shqiptarçe. Ishte kjo që e preku më shumë. Si shqiptar që ishte, e kishte të vështirë që dikush t'ia shihte lotët. Mezi priste sapo të dilte nga salla e ceremonisë. Rrugës për në shtëpi u ndal te kisha e Shën Stefanit. Për herë të parë nuk u ndje mëkatar. Kishte bërë atë që duhej. I kishte mbetur besnik vetvetes. Kishte përfunduar një sfidë të jetës. Do të kthehej aty ku ishte nisur. Hapat po e çonin ngadalë afër shtëpisë. Nuk ngopej duke parë gjithçka rreth e rrotull, a thua se nuk do t'i shihte më kurrë. Kur hapi derën e baxhës, ulur në kënd, aty ku e kishte gjetur edhe shumë herë të tjera, gjeti Sofinë. Ajo gjithmonë i ishte dukur si një rreze dielli që sapo i kishte hyrë në shtëpi. Priste një gjëmë për vendimin që kishte marrë, por kishte

ndodhur e kundërta. Në një rrëke lotësh, ndërsa të dy e shihnin turbull njëri-tjetrin, Sofia i dha një të puthur të shkurtër. Në dorë i vendosi një letër të gjatë, kuptimi i së cilës do ta ndiqte gjatë dhe do të ishte çasti që do ta bënte tolerant për gjithë jetën.

Të nesërmen në mëngjes plaku Fritz do t'i shoqëronte deri në stacionin e trenit. Në duar mbanin valixhet e mbushura me libra dhe kujtime. Do të ktheheshin nga e njëjta rrugë, nëpër të cilën kishin ardhur. Në ndryshim nga koha kur kishin ardhur, tani ktheheshin me kokën plot. Kudo që do të shkonin, pasurinë e mbanin me vete. Nuk ishte nevoja të bënin investime të mëdha. E kishin bërë investimin në atë vend, të cilin mund ta merrje me vete dhe ta përdorje kur të doje. Kishin ardhur si djem të hutuar province. Tani kishin marrë formën e një intelektuali europian që mund ta përdornin profesionin në çdo vend të botës. Stacioni i trenit nuk kishte pësuar ndryshime që nga koha që ata e kishin parë për herë të parë. Të vetmit që kishin ndryshuar, ishin ata. Nuk kishin më atë kureshtjen e madhe. Ishin bërë më të rafinuar. Askush nuk mund t'i dallonte dot që nuk ishin vjenezë. Sikurse e kanë zakon, shqiptarët përshtaten në atë masë të madhe saqë bëhen më vendas se vetë vendësit. Fritzi ishte dyfish i kënaqur për mundësinë që u kishte dhënë Vjena djelmoshave dhe për mënyrën fisnike se si e kishin shfrytëzuar këta djem të mrekullueshëm dhe të pastër këtë mundësi. Kur treni u nis, plaku i ngratë i kishte ngritur të dyja duart duke i përshëndetur. Ndërkohë që treni merrte rrokullimën, ata